# Mësuesi

*Cilësi në arsim*

*Botim i përdyjavshëm i MASH nr. 7 (2553) - tetor 2010*




TRADITË&KULTURË



MËSUESI&NXËNËSI



ARSIMI&REFORMA



SHKOLLA&KOMUNITETI

Në Ditën Botërore të Mësuesit, 5 Tetorit, i urojmë të gjithë mësuesit:

## "Suksese në punën tuaj fisnike!"

EDITORIAL

## *Një zile celulari në klasë*

*Veledin DURMISHI*

Askush nuk do ta dëshironte atë moment, kur një zile celulari, krejt papritur, përveç se të jep atë ndjesinë e një alarmi, të prish edhe rrjedhën e mendimi a përjetimi. Kjo është gjendja nga e cila askush nuk mund të shpëtojë dot. Ndërsa mësuesi a pedagogu flet, shpjegon diçka, bie një zile celulari. Mësuesi, që për minuta të tëra i kishte futur nxënësit brenda rrëfimit të vet, befas një zile diku në klasë, që nxënësit i mbajnë poshtë bankës, në çantë a në xhep, e nxjerr atë jashtë funksionit të vet si mësimdhënës.
Dhe dolëm kështu tek një problem të cilin e dëgjojmë gjithnjë nga mësuesit e që përbën një shqetësim serioz për mbarëvajtjen e mësimit. Sepse celularët kanë pushtuar shkollën tonë. Dhe të tillë ka edhe në ciklin fillor, ndërsa në ciklet e larta ai është në modë, madje vihet re një rivalitet mes adoleshentëve dhe të rinjve se kush e ka celularin më të mirë e më të shtrenjtë. Me blu-tooth, me kartë memorie, nokia motorola, etj. Dhe kjo mani po na pushton. Prindërit, shpesh, më parë se të mendojnë për të tjera

*vijon në faqen 2*


**ARSIMI DHE REFORMA**
**Kurrikula jonë e matematikës dhe testet ndërkombëtare të PISA-s**

*Në deklaratat themeluese të PISA-s si një institucion vlerësimi në përputhje me studimet e bëra unifikohet edhe synimi i arsimit matematik në arsimin 9-vjeçar. Aty thuhet shprehimisht se kjo shkollë duhet të përgatis një qytetar që luan një rol aktiv në shoqëri.*

**SHKOLLA DHE KOMUNITETI**
**Institucioni i shkollës në kontekstin sociopolitik**

*Në shoqërinë e sotme bashkëkohore dhe demokratike ka ndryshuar botëkuptimi dhe qasja ndaj shkollës si institucion shumë i rëndësishëm në shërbim të shoqërisë, në shërbim të edukimit dhe përgatitjes së njeriut të së sotmes dhe të së nesërmes.*

**TRADITË DHE KULTURË**
**Prof. Bedri Dedja - Misionar i arsimit shqiptar**

*Në leksionet e tij nuk na mësonte vetëm psikologji, por na jepte edhe mendësi të reja në marrëdhëniet pedagog-student e anasjelltas. Na trajtonte si shokë e shoqe dhe na merrte kurdoherë mendimin tonë të sinqertë. Shkurt, na trajtonte si subjekt dhe objekt të edukatës.*


*Fëmijët e shkollës shqipe të Sarantit, Greqi*



Përmajtja: faqe


Ministri në Moskë
Ministri Tafaj në Konferencën e Parë Ndërkombëtare të UNESCO-s 3

Konferenca për Gjuhën shqipe dhe letërsinë. 4

Intervistë me Z. Murat Gecaj 5-6

*Arsimi & Reforma*

Kurrikula jonë e matematikës dhe testet ndërkombëtare të PISA-s 6-9

Mbi misionin dhe veprimtarinë e Inspektoratit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar (IKAP) 10

*Mësuesi & Nxënësi*

Këshilla për vitin e ri mësimor 11

Ora e mësimit është "laborator" 12

Si të planifikojmë një orë mësimore. 13

Orë Model: Gjuhë shqipe, Klasa IX 14

Roli i mësuesit në vlerësimin e jashtëm të kurrikulës 15-16

Vlerësimi i punës së mësuesit 17

*Shkolla & Komuniteti*

Institucioni i shkollës në kontekstin sociopolitik 18-19

Roli i prindit në shkollë. 20

Mësuesi zemra e tolerancës 22

*Traditë & Kulturë*

Dashuria për gjuhën amtare te fëmijët tanë 24

Prof. Bedri DEDJA Misionar i arsimit shqiptar 25

Çfarë duhet të di mësuesi për shëndetin publik në shkolla? 27-30


# Një zile celulari në klasë

çështje që shqetësojnë mbarëvajtjen e fëmijës në shkollë, mendojnë për celularin që i duhet atij. Vërtet, ata janë një mundësi e madhe komunikimi, është një marrëdhënie e re virtuale me botën, por ajo fsheh edhe rrisqet e veta të cilat, shoqëria duhet t'i njohë. Kjo teknologji e re moderne po hyn vrullshëm ndër ne duke na treguar kryesisht anën e vet pozitive, ndërsa përditë e më tepër ndërgjegjësohemi, se në raport me shkollën dhe auditoret, ata kanë edhe anën tjetër, negativen. Shpërqëndrimin jo rrallë të nxënësve në klasë, pas zileve e vibrimeve të tyre. Sigurisht që zilet thirrëse, në shumicën e rasteve, nuk vijnë prej prindërish të preokupuar dhe si të thuash "kontrollues" ndaj pjesëmarrjes së fëmijës në mësim dhe në klasë, gjë që unë si shkrues i këtyre rradhëve do ta mirëkuptoja shumë, por rëndom nga grupmoshat e tyre, shokët dhe shoqet e klasës, shkollës dhe me gjërë. Me maninë për të krijuar lidhje të reja, për të shkëmbyer mesazhe me të njohur e të panjohur e kështu, kjo "drogë elektronike" u merr kohën, i largon nga misioni për të cilën ata shkojnë në shkollë. Aq pengues bëhet ky fenomen sidomos në ndonjë klasë dhe shkollë ku vetë



mësuesi, i përgjigjet thirrjes së celularit të tij pa pikë droje dhe etike profesionale, gjatë orës së mësimit, saqë klasa tashmë ka dalë nga kontrolli duke vënë në dyshim arritjen e qëllimit të mësimit dhe realizimin e objektivit të tij. Në krizë, tashmë është vënë autoriteti i mësuesit dhe i fjalës së tij. Në të dy rastet, ky mësues sikur është jashtë loje. I duhet kohë të krijojë dhe rimarrë situatën për një mësim efektiv dhe të larmishëm. Celulari sjell domosdoshmërish një shpërndarje të vëmendjes, një ulje të aftësive në procesin e mësimit, aq më shumë, kur lidhja me të bëhet aq e ngushtë, sa nxënësi mund të shkojë në shkollë pa libra e detyra, por kurrsesi pa celular! Shkolla e di mirë, efektin celular, por tani ka ardhur koha që të hidhen hapa konkrete, ndaj largimit të përdorjes së celularit nga klasat e mesimit dhe ndonjë mësues. Që do të thotë një rritje e përgjegjësisë ndaj shkollës, do të thotë t'i japësh procesit mësimor rëndësinë e duhur e të ndihmosh mësuesin të kryejë misionin e vet Rrugët efektive të mënjanimit të tyre mund dhe duhet t'i gjeje vetë shkolla dhe mësuesi. Po kush duhet të mendojë për të larguar celularët nga klasa më parë se shkolla e familja? Ka një vendim të Ministrisë së Arsimit, që i ndalon ata të jenë të përdorshëm në klasë, qoftë edhe celulari i mësuesit, atëhere pse hezitohet?. Me qëllim që në çdo klasë të dëgjohet mësuesi, fjala dhe autoriteti i tij, largimi i tyre duhet bërë çështje e ditës në çdo shkollë. E në këtë front duhet të jenë të ndihmues prindërit, të cilët të kenë të qartë se celulari që dikur i kanë blerë fëmijës së tyre, po e largon atë nga shkolla pa menduar pastaj për anë të tjera abuzive të cilat tani i njohim të gjithë.

# Ministri Tafaj në Konferencën e Parë Ndërkombëtare të UNESCO-s për kujdesin dhe arsimimin e fëmijëve



Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Z. Myqerem Tafaj, mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të UNESCO-s, me ftesë të Drejtoreshës së Përgjithshme, Znj. Irina Bokova.

Konferenca u zhvillua në Moskë në prani të përfaqësuesve të nivelit më të lartë qeveritar dhe delegacioneve të vendeve pjesëmarrëse. Kjo konferencë, e para në këtë format, iu kushtua çështjeve të arsimimit dhe kujdesit shëndetësor të fëmijëve.

Gjatë sesionit të diskutimit në konferencë, përcaktuar për vendet e Europës dhe Amerikës Veriore, Ministri Tafaj, edhe në funksionin e Kryetarit të Komitetit Kombëtar të UNESCO-s për Shqipërinë, paraqiti në dy seanca nismat dhe arritjet e Qeverisë shqiptare në sektorët që prekin arsimimin dhe kujdesin e fëmijëve.

Duke vënë theksin në prioritetin e programit të Qeverisë për ofrimin e një arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës, Ministri Tafaj theksoi objektivin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për t'i mundësuar çdo fëmije një vit përgatitor përpara fillimit të klasës së parë dhe ngritjen e infrastrukturës së nevojshme për këtë qëllim. Një rëndësi të veçantë gjatë prezantimit iu kushtua masave të ndërmarra nga ana e Qeverisë për mbrojtjen dhe përkujdesjen e fëmijëve të grupeve të margjinalizuara, në kuadër të programeve të bashkëpunimit me agjencitë e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri dhe partnerëve të tjerë.

Gjatë vizitës së tij në Moskë, Ministri Tafaj zhvilloi takim me studentët shqiptarë që studiojnë në universitetet ruse. Ai theksoi domosdoshmërinë e një shkollimi cilësor dhe i porositi ata të përfundojnë ciklet e plota të studimeve përfshirë edhe ato të doktoraturës, pasi Shqipëria ka nevojë të madhe për studiues që vijojnë traditën e mirë të shqiptarëve të diplomuar në universitetet ruse. Ai i njohu studentët me reformat e thella që po zhvillohen në universitetet shqiptare dhe i siguroi ata për kujdesin e vazhdueshëm që Ministria e Arsimit dhe e Shkencës po tregon për të gjithë të diplomuarit jashtë vendit tonë.

Ministri i Arsimit dhe i Shkencës, z. Tafaj, pati takime të shumta me homologë të tij, me Drejtoren e Përgjithshme të UNESCO, Znj. Irina Bokova dhe me përfaqësues të organizatave që ndihmojnë në fushën e arsimit. Ministri Tafaj u ftua nga shumë homologë për të vizituar vendet e tyre me qëllim shkëmbimin e përvojave në fushën e arsimit.



*Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Myqerem Tafaj me studentët shqiptarë ne Moskë*

# "Gjuha dhe letërsia në shkollë"

## *Konferencë shkencore për politikat, standardet - mësimdhënien dhe të mësuarit*

**Përgatiti: Besnik RAMA/MASH**

Në datën 30 shtator 2010, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë i Universitetit të Tiranës organizoi Konferencën Shkencore "Gjuha dhe letërsia në shkollë".
Konferenca i hapi punimet me fjalën e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, prof. dr. Myqerem Tafaj, i cili, pasi përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi organizatorët, shtroi para auditorit disa nga prioritetet e MASh-it në fushën e reformës arsimore, si: politikat dhe strategjitë arsimore, zhvillimi i kurrikulës, standardet për mësuesit, tekstet shkollore, mësimi i gjuhës shqipe në diasporë etj. Pasi theksoi se është përfunduar kurrikula e arsimit të mesëm, dhe se jemi në fazën e vlerësimit të kurrikulës së arsimit bazë nga ekspertë të Bankës Botërore, ministri Tafaj tha se do të punohet për vlerësimin e programeve nga specialistë të fushës, pasi ato janë plotësisht të stabilizuara. Një aspekt i rëndësishëm i punës në arsim ka të bëjë me mësuesit. Ne mund të investojmë për tekste, për pajisje të shkollave me mjete didaktike e laboratorë etj., por vendimtar është mësuesi. Mësuesit i japin jetë reformës në arsim. Njohja e zbatimi i metodat efektive të mësimdhënies dhe të të nxënit, përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe njohja e gjuhëve të huaja janë disa nga kërkesat për mësuesit e shkollës sonë. "Profesoriati i universiteteve tona, - shtoi më tej ministri Tafaj, - i ka të gjitha mundësitë që ne, brenda një dekade, të kemi një mësues të formuar sipas standardeve të shkollave europiane".
Duke trajtuar reformën e altertekstit, ministri Tafaj theksoi se "Kjo reformë ka krijuar hapësirë për konkurrencë. Botimi i teksteve shkollore në Shqipëri ka bërë hapa gjigantë. Këtë vit i kushtuam rëndësi nivelit të hartuesve të teksteve".
Lidhur me shkollat shqipe të mësimit plotësues në diasporë, zoti Tafaj u shpreh se fëmijët e emigrantëve shqiptarë në vendet ku jetojnë, duhet të mësojnë gjuhën shqipe. Një grup pune i përbërë nga specialistë e studiues hartoi programin e integruar të mësimit shqip në diasporë. Programi synon të afrojë nxënësit për të mësuar gjuhën shqipe, letërsinë, historinë, gjeografinë, trashëgiminë tonë kulturore. Ne kemi mbështetur me 3000 abetare emigrantët në Greqi etj. Por tekstet që përdorim sot në shkollat tona këtu në Shqipëri, nuk janë shumë të përshtatshme për fëmijët emigrantë. Programi i integruar do të finalizohet me tekste për fëmijët emigrantë. Megjithatë, problemi nuk është thjeshtë tek tekstet. Ne duhet të kërkojmë gjuhën shqipe si lëndë me zgjedhje. Kjo është një sfidë për ne. "Në momentin kur vendet ku jetojnë emigrantët, do të lejojnë futjen e gjuhës shqipe si lëndë me zgjedhje në kurrikul, atëherë qasja jonë do të jetë tjetër", - u shpreh ministri Tafaj. Ne do të na duhet të dërgojmë në diasporë mësues, që do të paguhen nga shtetet pritëse, por këta mësues duhet të njohin dhe të zotërojnë gjuhën e vendit pritës.







Në seancën plenare të konferencës u trajtuan probleme që lidhen me shkollën shqiptare, shoqërinë shqiptare dhe gjuhën shqipe sot, me traditat e studimit të letërsisë dhe me probleme aktuale të mësimit të gjuhës shqipe në shkollë, me gjuhën shqipe dhe dialektet e saj, me çështje të prurjeve alternative në interpretimin e programit dhe analizën e thellë t teksteve letrare, me politikat botuese lidhur me reformimin e teksteve të gjuhës shqipe, me mësimdhënien gjuhës shqipe në diasporë etj.
Më pas, konferenca i vazhdoi punimet në pesë seksione, ku u trajtuan çështje të zhvillimit të kurrikulës, u bënë vlerësime mbi standardet dhe programet e gjuhës shqipe dhe të letërsisë, u analizuan tekstet alternative në fokusin e reformës arsimore; u trajtuan probleme të planifikimit gjuhësor; u rrahën mendime rreth përgatitjes profesionale të mësimdhënësve; u prezantuan rezultate e përfundime nga vlerësimi i nxënësve në maturën shtetërore etj.. Në fokus të temave që u paraqitën në konferencë, ishin dhe probleme të formimit të mësuesve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë në universitete, mësimdhënia përballë TIK-ut, mësimi i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në universitete të vendeve të ndryshme dhe në diasporë, EPOSTL - Portofoli Europian për studentët e mësuesisë etj.
Në seancën e fundit të konferencës u bënë propozime mbi perspektivën e kurrikulës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë. Të gjitha propozimet e rekomandimet do t'i paraqiten MASh-it, si institucioni kompetent për ndërmarrjen e politikave për përmirësimin e kurrikulës dhe të standardeve.
Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë do të dalë me një botim të posaçëm me materialet e konferencës.

# Intervistë me Z. Murat Gecaj
# Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës së Arsimtarëve të Shqipërisë



***1. Si kontribues i përhershëm i "Mësuesit", cili do të qe mesazhi juaj për mësuesit sot?***

Që në fillim, dëshiroj të theksoj se është kënaqësi e veçantë për mua, që tani më jepet rasti, përmes faqeve të revistës së re "Mësuesi", t'i përshëndes dhe t'i uroj mësuesit e pedagogët, nxënësit e prindërit dhe t'u uroj nga zemra shëndet të mirë, arritje në punë dhe lumturi në familjet e tyre!

Nisa të shkruaja në faqet e gazetës "Mësuesi" që në numrat e parë të daljes së saj, pra në shtator 1961, kur atë e drejtoi me aftësi profesionale dhe pasion pedagogjik e psikologjik, Prof. Bedri Dedja-Akademik e "Mjeshtër i Madh". Nuk jam ndarë nga kjo gazetë as nga lexuesit e bashkëpunëtorët e saj asnjëherë, por sidomos në afër 22 vjet radhazi, kur shërbeva redaktor pranë saj, deri sa dola në pension, në nëntor 2002. Meqenëse, gjithnjë gjatë jetës sime mbi 70-vjeçare, kam qenë pranë shkollës, mësuesve e pedagogëve, nxënësve e studentëve dhe prindërve të tyre, dëshiroj të ndaj me ta interesimin e shqetësimin e vazhdueshëm, që lipset t'i dallojë ata, me synimin që brezi ynë i ri të rritet sa më i ditur e i kulturuar, i aftë e i gatshëm për t'iu përshtatur kërkesave të ekonomisë së tregut dhe të shoqësisë demokratike evropiane, ku dëshirojmë e jemi të vendosur të integrohemi.

***2. Cili është dallimi thelbesor, sipas jush, i mësuesve sot, në krahasim me ata të viteve të rinisë suaj?***

Ndoshta, kjo pyetja duket pak "e vështirë". Megjithatë, mendoj se mësuesit tanë, në vazhdim të traditave më të mira të shkollës sonë ndër vite e dhjetëvjeçarë, po bëjnë përpjekje të parreshtura që ta kryejnë misionin e tyre, pra të jenë mësimdhënës dhe edukatorë të zellshëm të fëmijëve tanë. Për fat të mirë, tani mësuesit i kanë kushtet e mundësitë shumë më të mira se ne më parë, pra që nga ndërtesat shkollore e pajisjet e tyre, orenditë e mjetet mësimore, programet e tekstet e tjerë. Në ndihmë të tyre janë mjetet e shumta të komunikimit masiv, si televizioni, kompjuteri e Interneti etj. Por kjo nuk do të thotë që ata të jenë të çkujdesur e të pavëmendshëm, pra kërkohet që dijet e aftësitë e tyre t'i venë sa më shumë e më mirë në shërbim të nxënësve të tyre. Lidhur ngusht me këtë veprimtari, mendoj se janë ndihma, kontrolli dhe vëmendja e organeve të specializuara e drejtuese mbi punën e tyre, që nga drejtuesit e shkollave, drejtoritë arsimore, komunat e bashkitë dhe vetë Ministria e Arsimit e Shkencës. Pra, mund të kryehen reformna të mira në arsim, të ketë dhe programne e tekste të përkryer, por këto lipsen shoqëruar me punë të ndërgjegjshme e të përkushtuar të mësuesve.

***3. A besoni se mësuesit kanë ndikimin më të madh në shoqëri?***

Mësuesit e pedagogët tanë janë jo vetëm mësimdhënës dhe edukatorë të nxënësve e studentëve, por këtë funksion e kanë dhe duhet ta kenë edhe ndaj prindërve të tyre e më gjerë, në shoqërinë tonë demokratike. Ndikimi dhe puna e mësuesve e pedagogëve në shoqëri kanë shumë anë të tyre. Por e quaj me vend të theksoj këtu se, duke u bazuar dhe në përvojën e mëparshme të shkollës sonë, kërkohet që të rritet më tej roli i saj në jetën shoqërore të vendit. Për këtë gjë, ndoshta, duhet menduar e filluar puna që nga organizimi e zhvillimi i veprimtarive jashtëshkollore dhe nxitja e zhvillimi i talenteve të reja, përmes formave e organizimeve sa më të dobishme.



***4. Si i këshilloni ju mësuesit sot të pershtaten me ndryshimet e shpejta rajonale dhe evropiane te zhvillimit?***

Është gjë e bukur e mjaft domethënëse fakti që Shqipëria jonë demokratike është përfshirë në mënyrë dinamike e me arritje të shënuara në zhvillimet rajonale dhe evropiane. Prandaj dhe roli e detyra e shkollës sonë, pra dhe e mësuesave e pedagogëve tanë, për ta përgatitur e aftësuar brezin e ri, që t'u përshtatet këtyre ritmeve, është i madh e i pazëvendësueshëm. Këtë gjë ata mund e duhet ta relizojnë brenda mureve të shkollës e jashtë saj, në bashkëveprim të ngushtë me prindërit e shoqërinë civile dhe gjithë faktorët tjerë, integrues e zhvillues të përparimit të përgjithshëm.

***5. Mesazhi juaj për nxënësit e studentët shqiptarë...***

Me këtë pyetje, më kujtuat vitet e mia të shkuara, si nxënës e student. Sjell ndërmend këtu me nderim mësuesit e pedagogët tanë, të cilët nuk kursyen energjitë mendore as fizike që ne të bëheshim sa më të ditur e të kulturuar. Këshilla ime është që brezat e sotëm të nxënësve e studentëve ta vlerësojnë sa më mirë periudhën, që përjetojmë dhe të përfitojnë nga kushtet shumë më të mira, që kanë sot, në krahasim me ne brezin tonë. Po kështu, ta vlerësojnë e ta njohin të kaluarën, me të mirat e të metat e saj dhe kështu të mos kursehen që të ecin gjithnjë përpara. Njohja, respektimi dhe nderimi i traditave ed punës së paraardhësve, në familje, në krahinë e në shkallë vendi, është detyrim moral dhe krijon premisat që edhe brezin e sotëm ta nderojnë e vlerësojnë brezat pasardhës. Këshillë tjetër e imja, si publicist e studiues, është që ata mos t'u ndahen librave, kërkimit e studimit gjatë tërë jetës. Në këtë mënyrë, do të bëhen "dikushi" në jetë dhe të respektuar e të dobishëm për veten e mbarë shoqërinë shqiptare.

***6 Mesazhi juaj per revisten "Mesuesi"...***

Revista "Mësuesi" është një risi e lavdërueshme e stafit aktual të MASH-it. Dëshiroj, uroj e kam besim se kjo revistë do ta përligjë veten ndërmjet shtypit të shkruar shqiptar, sidomos atij pedagogjik, duke u bërë tribunë e mendimit të përparuar dhe e arritjeve më të mira në fushën e edukimit dhe mësimit. Do t'i këshilloja, si mësuesit dhe drejtuesit e arsimit, në të gjitha nivelet, që jo gvetëm ta lexojnë me dëshirë këtë revistë, por dhe të bashkëpunojnë me të, duke pasqyruar përvojën dhe arritjet e tyre në mësim, edukim dhe veprimtaritë e ndryshme etj.

Së fundi, i uroj stafit të kësaj reviste punë të përkushtuar dhe sa më profesionale e cilësore në publikimin e arritjeve më të mira të shkollës shqiptare, e cila po përpiqet dhe punon me ngulm që të integrohet me dinjitet në rrjedhat e shoqërisë demokratike evropiane.

***Ju falënderoj që zhvilluam bashkë këtë intervistë!***

# Kurrikula jonë e matematikës dhe testet ndërkombëtare të PISA-s

**Agron TATO**
**pedagog në UE "Aleksandër Xhuvani"**

**Në deklaratat themeluese të PISA-s si një institucion vlerësimi në përputhje me studimet e bëra unifikohet edhe synimi i arsimit matematik në arsimin 9-vjeçar. Aty thuhet shprehimisht se *kjo shkollë duhet të përgatis një qytetar që luan një rol aktiv në shoqëri.***

Siç dihet, qysh prej vitit 97' organizata për zhvillim dhe bashkëpunim ekonomik (OECD) ka adaptuar një program për vlerësim ndërkombëtar të nivelit të arsimimit të nxënësve -(PISA) për moshat 15-vjeçare. Kjo moshë koinçidon me përfundimin e arsimit të detyrueshëm në shumicën e 43 vendeve që marrin pjesë në këtë organizatë. Vitet e fundit ky arsim po zbatohet dhe në vendin tonë, si një nga vendet pjesëmarrëse. Është vendosur që vlerësimi në fjalë të bëhet çdo 3 vjet duke filluar nga viti 2000. Vendi ynë arriti të përfshihet në testimin e vitit 2003, por për disa arsye që nuk është vendi të diskutohen në këtë artikull, ky testim nuk u organizua siç duhet dhe nuk ekziston asnjë raportim ndërkombëtar për rezultate të këtij testimi që, si rregull, publikohen për t'ju bërë të ditur vendeve përkatëse gjendjen e arsimimit të tyre. Testimi i radhës për shkencat natyrore ka qenë në vitin 2006 dhe, besohej se këtë radhë punët do të shkonin më mirë, por nuk ndodhi kështu, për disa probleme teknike dhe organizimi. Vlerësimet e deritanishme orientohen në tri fusha kryesore: aftësia për të lexuar dhe kuptuar gjënë e shkruar, aftësimi në matematikë dhe aplikimi i shkencave.
Ndonëse ne nuk kemi rezultatet zyrtare të testit të 2003, të cilat gjenden, qoftë dhe të pjesshme, në dikaster, kjo nuk do të thotë që kjo çështje të mos bëhet objekt diskutimi i cili të na çojë në analizën e duhur për të vënë gishtin në dobësitë që paraqet arsimimi ynë, në mënyrë që në të ardhmen ky arsimim që nuk është aspak për t'u nënvlerësuar, të zërë në kuadrin evropian një vend dinjitoz dhe të merituar. Pikërisht, kjo është arsyeja që na nxiti për të përmbledhur disa vërejtje për kurrikulën dhe tekstet tona të matematikës në përdorim, të cilat me modesti besojmë se do të nxisin sado pak debatin dhe kritikën për të vënë në lëvizje proponentët e "teknologjisë sonë të të mësuarit të matematikës".

## 1. Cilët janë synimet e arsimit matematik në shkollën 9-vjeçare?

Duket se pas këtyre 25-30 vjet pune me programet e reja dhe rinovimit të vazhdueshëm të sistemit tonë arsimor, tashmë jemi të përgatitur për t'i dhënë një përgjigje adeguate kësaj pyetjeje. Sigurisht, të ndodhur në proces integrimi me vendet e tjera europiane do të kemi parasysh edhe përvojën dhe arritjet e të tjerëve. Ajo që mund të duket shqetësuese në ambientet tona pedagogjike është frika nga ndonjë adaptim "i pazëshëm", që do të thotë: pa ndonjë debat të gjerë dhe serioz paraprak, adaptohet një model nga ndonjë grup pune që nuk guxon të shprehet hapur nga është marrë dhe pse është zgjedhur ky model, i cili pas shqipërimit shpesh konsiderohet "i përpunuar thellë", pra është shumë larg origjinalit sa mund të konsiderohet "rikrijim". Pas përfundimit të kësaj pune shpesh voluminoze dhe të dobishme, gjendet një "formulim zyrtar" në të cilin shkruhet në mënyrë evazive se në fund të nëntë viteve nxënësi duhet të jetë në gjendje: të njohë dhe të operojë me numrat racionalë, të njoh figurat gjeometrike dhe vetitë e tyre, të shpreh relacionet ndërmjet bashkësive etj. Ka ardhur koha të bëjmë vlerësimet e duhura për çdo hallkë dhe çdo segment të sistemit tonë arsimor. Duke patur parasysh se një pjesë e madhe e të rinjve 30-40% (49% në vitin 2001) nuk vazhdojnë shkollat e mesme del se pesha e këtij arsimimi është e madhe dhe do të jetë për shumë kohë.
Në deklaratat themeluese të PISA-s si një institucion vlerësimi në përputhje me studimet e bëra unifikohet edhe synimi i arsimit matematik në arsimin 9-vjeçar. Aty thuhet shprehimisht se kjo shkollë duhet të përgatis një qytetar që luan një rol aktiv në shoqëri. Ajo duhet të jetë përgjegjëse për të edukuar aftësitë e nxënësit për përdorur dhe vënë në jetë ato që ka mësuar në shkollë. Përsa i përket matematikës, ai duhet të përballoj nevojat e jetës së përditshme që bëhet gjithnjë e më e ndërlikuar duke zgjidhur detyra konkrete si: të menaxhojë financat personale, të zhvillojë transaksione të thjeshta financiare, të bëjë blerje të leverdishme, të njohë grafiket dhe diagramet e lëvizjes së mjeteve të transportit, të kuptojë informacionet ekonomike, "shoqëria e sotme e informacionit" ofron konceptin e ri të papërcaktueshmes që shprehet në mënyrën e rritjes së çmimeve, rezultatet e zgjedhjeve, rritja e popullsisë, dijeni për efektet e ngrohjes globale dhe mbrojtjen e mjedisit.
Në realizim të arritjes së këtyre objektivave strategjike është e nevojshme nxjerrja e disa standardeve të pranueshëm dhe të matshme të aftësimit matematik që kërkohet. Duke u larguar frazave standarde dhe përmbajtje të varfër që u përmendën më lartë për shkollën 9-vjeçare, me aftësim në matematikë (me term ndërkombëtar-literaci matematike) duhet kuptuar : aftësimi i nxënësit për të identifikuar dhe kuptuar rolin e matematikës në botën që na rrethon, për të qenë në gjendje të përdor mjete matematike, për të dhënë një gjykim të drejtë dhe të bazuar në jetën praktike të tij për t'u bërë një qytetar konstruktiv, bashkëpunues dhe reflektiv në shoqëri.[9].

Siç duket qartë në qendër të procesit edukativ vendoset individi si pjesëtar i një shoqërie të së tashmes dhe të ardhmes të një bote në zhvillim. Kuptimi i qartë dhe zbërthimi i këtyre objektivave do të zvogëlonte së tepërmi dilemat për të përcaktuar se çfarë duhet të zhvillojë nxënësi në matematikën e klasës së shtatë apo të tetë, gjë që duke mos patur një vizion të qartë se ku duam të arrijmë, në praktikën tonë të deritanishme, ka çuar në zgjidhje subjektive dhe apriori. Së dyti, nga këto objektiva del se kërkesë e rëndësishme nuk është vetëm realizimi me cilësi i kurrikulës shkollore, gjë që në të vërtetë mbart në vetvete shumë probleme, por në plan të parë duhet të dal produkti i saj që është aftësia për të tejkaluar çështjet që përballen në jetën praktike, probleme që



si metodë bazë për përvetësimin nuk duket si shumë e argumentuar dhe këto të kujtojnë metodat bihaveriste të cilat qëndron larg të mësuarit real logjik. Së dyti, jo të gjithë nxënësit kanë të njëjtin mënyrë të përvetësuari ose të paktën jo me të njëjtin ritëm. Duke qartë se shumë mësime janë të ndërtuar për një trajtim horizontal, pra pa futur elemente të reja, por vetëm përsëritje për përforcim. Kjo metodë e zbeh interesin e nxënësit për lëndën dhe e bën matematikën jotërheqëse dhe rutinore. Për moshat 6-10 vjeç nuk duhet të abuzohet me faktin që të mësuarit e tyre nuk është në shkallën e duhur i ndërgjegjshëm, përkundrazi ne duhet t'i shtyjmë ata ta duan me të vërtetë këtë lëndë. Mjafton të shqyrtojmë materialet e punës dhe detyrat që duhet të përmbush nxënësi në matematikën 2 dhe 3, ku përveç punës në libra, të cilat kanë nga 160-180 faqe,

mund të zgjidhen me anë të matematikës, e cila të ndihmojë të merret një vendim i drejtë në një rrethanë të caktuar. Ky më duket një këndvështrim i ri i cili bën që të rishikohen me kujdes të gjithë programet dhe tekstet tona mësimore për të bërë plotësimet e nevojshme. Ndonëse vitet e fundit janë bërë shumë përpjekje për të shkrirë ndarjet tradicionale të studimit: algjebër, gjeometri, varësi funksionale etj., megjithatë kurrikula shkollore vuan nga ngarkesa rutinore që procesin e krijimit dhe operimit me konceptet matematike e trajton të ndarë ose veçmas zbatimit të tyre në jetën praktike. Kjo e bën mësimin të vështirë dhe e vë logjikisht në drejtim të kundërt të rrjedhës historike dhe praktike, mësimi bëhet monoton pa fillim dhe pa fund dhe motivimi fillohen dhe zbehet, matematika shndërrohet një dogmë. Nga kjo pikëpamje duhet ndjekur teza e njohur e një rryme bashkëkohore e quajtura edukimi realist në matematikë:
Matematika nuk është vetëm një lëndë mësimore por një aktivitet human me qëllime aplikimi.[1].

**2. Matematika një aktivitet human**

Kjo tezë e hedhur vite më parë nga pedagogu i shquar holandës Freudental ka bërë që kurrikula shkollore të rivlerësohet vazhdimisht për të gjetur raportin më të drejtë të njohurive thjeshtë teorike dhe zbatimit të tyre. Idetë sa të vjetra edhe të reja se mësohet më mirë duke vepruar dhe sendërtuar dhe se materialet didaktike kur jepen të gatshme dhe të papërpunuara më parë nga nxënësit janë të padobishme dhe antididaktike, janë shfaqur herë pas here gjerësisht edhe në tekstet tona [2],[3],[7]. Ideja që matematika duhet të jetë e lidhur me realitetin e afërt për nxënësin dhe ta lidh atë me shoqërinë gjen shprehje në ciklin e ulët në përdorimin e mjeteve të thjeshta si petëzat e ndryshme katrore, trekëndore e rrethore, figurina të ndryshme të luleve, frutave e perimeve si dhe elemente nga bota shtazore, të cilat të gjitha së bashku bëjnë të mundur formimin e kuptimit të numrit me kontekst. Këto mjete synojnë të konstruktojnë një realitet të cilët fëmijët nuk e ndeshin në mënyrë kaq të pasur dhe të kompletuar në ambientin dhe komunitetin ku ata jetojnë. Përdorimi i bashkësive të tilla konkrete për të realizuar përvetësimin e konceptit të numërimit dhe të veprimeve me numra duket, tani për tani, si metoda më e pranueshme. Kritikat që bëhen në këtë drejtim kanë të bëjnë më shumë me ritmin e imponuar të mësimit. Së pari, copëzimi i kapitujve në mënyrë plotësisht rigoroze dhe përsëritja e vazhdueshme

nxënësit i duhet të plotësojë dhe fletoret e punës 320-370 faqe[5] dhe i takon që ai çdo ditë duhet të plotësojë vetëm ushtrime në libra 3 faqe, pa llogaritur detyrat e shtëpisë që zakonisht janë me shkrim. Sigurisht, në këto rrethana shtrohet pyetja në ka rrugë më të shkurtër dhe më efikase? Besoj se po, duke prishur monotoninë e teksteve aktualë mësimor, duke mos i konsideruar tabu dhe si fjala e fundit e pedagogjisë, duke qenë krijues, duke futur elemente tërheqës dhe argëtues si teste të ndryshëm dhe gjëza (quize) të ndryshme, dhe që është më kryesorja, duke futur problema nga jeta e përditshme familjare me atë, që e bën nxënësin të ndjehet i dobishëm nga njohuritë që fiton, që shuan kuriozitete etj.
Puna për studimin e procesit të të mësuarit tek nxënësi jo vetëm që nuk ka përfunduar në rang botëror, por përkundrazi, në ditët e sotme ajo po njeh një zhvillim të ri, si një nevojë e mileniumit të ri. Jehona e këtij debati për fat të keq nuk ndihet shumë tek ne (ndoshta kemi fatkeqësinë e të ndjerit inferior apo të ndjenjës së të priturit të çdo gjëje nga jashtë) veçse në rastin kur ndonjë autor në kuadrin e ribotimeve fut ndonjë "element të ri" që praktikisht stonojnë me rrjedhën e tekstit ose të teksteve siç mund të vihen re dallime tek matematika 6,7 dhe 8.[6] ,[10].
Është e çuditshme por është fakt se tekstet e reja të shkollës 9-vjeçare vijnë vetëm në shtator dhe asnjë mësues nuk ka dijeni se çfarë përmban ai dhe cila është metoda e përdorur. Kjo ndodh se autori nuk i ka bërë të ditur idetë e tij apo të frymës së re që duhet të ketë programi i ri. Çdo gjë duket se vjen nga lart nga "njerëzit e përgatitur" (autorët) të cilët me siguri nuk kanë as vetëm ndonjë punim dinjitos për rrymën që kanë zgjedhur. Teksti në fjalë ndonëse është fitues i një konkurrimi në dikaster nuk dihet se nga kush është përzgjedhur nga profesionistë, apo bosa të shtypshkrimit. Teksti nuk duket qartë nëse është libër për mësuesin apo për nxënësin sepse në faqe të parë vihen pikat e planit dhe konsiderohet libër teorie?![10]. Kjo është e palejueshme dhe nuk mund të pranojmë që tekstet e shkollës së re të jenë një përzierje amatore idesh, rrymash dhe metodash. Në këto kushte, krijohet fobia e një teksti "bombë", së pari, për metodikën që duhet të përdor një mësues i përgjegjshëm. Në një situatë të tillë por me sens pozitiv janë gjendur mësuesit dhe më parë kur teksti (shih[6]), i parë me synimet e metodës së njohur si metoda realiste është plotësuar me forma të tilla novatore si: nisja e kapitullit me një problem të rëndësishëm dhe parimor[faqe



14,28,31 etj.], përdorimi i mjeteve humoristik si p.sh. ligji i numrave shprehet në mënyrë të figurshme si një ligj i mbretit butaforik[faqe 16,105 e tj.], futja një numri të madh problemesh nga praktika e përditshme e shitblerjes, përgatitja e dialogëve ku duhet gjetur gabimet në shprehje, ndërtimi i problemeve sa më afër realitetit që ndesh nxënësi, problemet e zbatimit e bëjnë këtë tekst dinamik dhe tërheqës, gjë që nuk ndodh tek [7], ku dominojnë veprimet algjebrikë dhe zgjidhja e ekuacioneve si një qëllim matematik në vetvete, pa u integruar me probleme me kontekst, ku shtrimi i ekuacioneve dhe zgjidhja e tyre të ishin pjesë e problemit. Mënyra e derisotme, sidomos në klasat e larta të kësaj shkolle, ku alternohen kapitujt e algjebrës dhe të gjeometrisë pa asnjë lidhje ndërmjet tyre duhet të ndryshojë sa më shpejt ose të kalohet në ndarjen e tyre në dy lëndë të veçanta.

**3. A mund të aftësohen nxënësit për të zbatuar matematikën?**

Duke e parë në retrospektivën e saj, mësimdhënia e matematikës në shkollën tonë ka pasur historitë e saj të ulje-ngritjeve. Nën presionin e kërkesave për një sukses masiv, shpesh të imponuara politikisht, shkolla reflektoi me përpjekjet për një punë të diferencuar në klasë. Të gjithë i mbajnë mend këto metoda pune, ku klasa ndahej në dy pjesë (dhe shpesh në dy rreshta), ku me njërën palë, me më të aftit zhvillohej programi i plotë që përmbante dhe zgjidhje të problemave si pjesë e tij, kurse të tjerët,"të prapambeturit" aftësoheshin për të zgjidhur ushtrime të thjeshtë me terma matematike ose të paktën mësonin ndonjë algoritëm si mund të gjesh bie fjala një të panjohur. Pra, ky raport paraqitej i përmbysur, ata që kishin probleme në të përvetësuarit të matematikës u jepej teoria e saj e pastër pa kontekstin gjë të cilën, siç dihet, janë të aftë ta përvetësojnë vetëm ata që kanë shkallë të lartë abstraksioni. Sigurisht, në atë kohë ishin të panjohura pikëpamjet e Gardnerit për ekzistencën e inteligjencave të shumëfishta. Gardneri provoi se këto inteligjenca gjenden në masë të ndryshme në nxënës të ndryshëm. Kjo mosnjohje nuk e justifikon, megjithatë, formalizmin e tepruar në punën me nxënësin të asaj kohe, kohë e cila për gjendjen e sotme të punëve në shkollë konsiderohet një moment relativisht i suksesshëm për arsimin tonë.
Edhe në ditët tona është për të ardhur keq që problemet që hasen në tekste kanë për qëllim më shumë të praktikojnë rregullat e veprimeve matematike sesa të lidhen me ndonjë çështje të realitet që na rrethon, kjo sjell frikën që kanë nxënësit nga problemet dhe zgjidhja e tyre, për shkak të praktikimit të pakët të tyre.

Të përpiqemi më poshtë të rreshtojmë disa kushte që do të lejonin aftësimin më të mirë të nxënësve në zgjidhjen e problemeve me përmbajte reale.
Së pari, duhet saktësuar konteksti i operimit të tyre. Një problem konkret real i marrë drejtpërdrejt nga jeta nuk është e mundur të trajtohet jo vetëm në këtë shkollë por edhe në shkolla më të larta. Këto probleme duhet të mbeten si një qëllim për të cilin duhen marrë masat përgatitore dhe të hidhen hapat e duhura. Kjo bën që ne të zgjedhim si objekte rrethanore ato që janë të lidhura me aktivitetin e nxënësit në shkollë, në punën e prindërve dhe në komunitetin lokal ku ai jeton. Pra, kryesorja është që konteksti të kuptohet dhe pranohet nga nxënësi. Këtu ka rëndësi sidomos në problemet që shprehen me fjalë që të mos përdoren koncepte të cilat nxënësi nuk i kupton ose shpjegimi i tyre na hap një punë të re, siç janë shprehjet : shpenzoi, harxhoi tek [3] apo fitimi i një firme tek [6] etj.

Së dyti, duhet bërë një ndarje e qartë ndërmjet tipeve të problemeve dhe metodikën e përvetësimit të tyre. Në qoftë se një problem ka një kontekst që lidhet me veti gjeometrike apo relacione matematikore që shprehet me terma dhe simbole të gatshme matematike ai duhet konsideruar si i afërt me njohuritë e marra dhe do të përdornim termin problem brendamatematik (inter-matematik) ose një situatë teorike. Tipi i dytë i problemave janë ato që kanë lidhje me matematikën por kjo lidhje mund të bëhet e dukshme në qoftë se punojmë me kontekstin. Të tilla janë problemet e zakonshme që gjenden në tekste të marrë nga një realitet i dhënë për të cilat duke punuar me modele tipike mund të aftësohemi si t'i kuptojmë dhe si t'i shprehim të dhënat me terma matematike. Këto konsiderohen si problema jashtmatematike(extra-matematike). Një tip i tretë dhe ndoshta më i vështiri është rasti kur problemi nuk lidhet me ndonjë realitet konkret por thjeshtë hipotetik dhe formulimi i tij përdor njohuritë matematike. Këtë tip mund ta konsiderojmë tipin e problemit shkencor.

Një çështje parimore që shkolla përgjithësisht e ka zgjidhur është baza teorike që kërkon zgjidhja e problemeve që pretendohet të realizojë nxënësi në përfundim të këtij sistemi shkollor. Këto ide apo koncepte bazë janë ato që reflektojnë të gjithë ndërtimin e kurrikulës shkollore që shprehet si në lëndë : si aritmetika, algjebra gjeometria, të cilat formalizojnë këto ide kryesore : sasia, hapësira dhe forma, relacioni dhe transformimi dhe së fundi dhe papërcaktueshmëria. Ndonëse për lehtësi përvetësimi këto koncepte duhen sistemuar në vite dhe kapituj të veçantë, nuk ndodh kështu në botën reale, ku këto kuptime nuk i gjejmë të ndarë dhe të dalluar nga njëri tjetri. Për të zgjidhur një problem të dhënë na duhen ide të ndryshme herë nga një kapitull dhe herë nga një tjetër. Kjo tregon se një moment i rëndësishëm që shpesh anashkalohet është zgjidhja e probleme komplekse. Këto mund të lidhin njohuri nga dy kapituj apo më gjerë dhe nuk janë të nevojshëm vetëm për nxënësit me përparim të mirë por shërbejnë si teste për nivelin e përgatitjes së të gjithë klasës. Kjo do ta bënte lëndën më solide dhe është ndoshta mënyra e vetme për të realizuar atë ide që shumë e reklamojnë me të madhe se ka vetëm një matematikë dhe se kursi shkollor duhet të ketë vetëm këtë emër. Është me vend të përmendim këtu lidhjen ndërlëndore e cila vazhdon të jetë e dobët dhe jo e sinkronizuar. Kursi i fizikës mund të ishte mjaft i dobishëm për të zgjidhur problema me kontekst dhe të vinte në punë

njohuritë më të rëndësishme matematike por si mund të pretendohet një gjë e tillë kur fizika trajtohet si një lëndë e izoluar në vetvete, kur p.sh. Fizika 7 [8] ka 77 tema të ndryshme të palidhura mirë me njëra tjetrën që u korrespondon pothuaj të gjithë koncepteve të fizikës të shkollave të larta. Matematika më e përdorur atje është ekuacioni homogjen me një ndryshore.

Është e qartë që sado mirë të zotërojmë kuptimet bazë ato nuk mund të mjaftojnë për të qenë të aftë në zbatimin e matematikës. Një aftësi shumë e rëndësishme që duhet edukuar në shkollë është matematizimi i situatave konkrete. Ajo shpreh kapacitetin e vërtetë të nxënësve për të vëzhguar, analizuar, gjykuar dhe komunikuar idetë matematike në mënyrë efektive, duke marrë vendime të drejta dhe më të përshtatshme. Ky proces kërkon nga nxënësi shprehi dhe kompetenca që ai ka fituar gjatë shkollimit por dhe përvojës së tij vetjake. Le të kujtojmë se çfarë kuptonte me matematizim Njutoni në veprën e tij të famshme”Principet matematike të filozofisë natyrore”:
“Por qëllimi ynë është vetëm të ndjekim dhe veçojmë sasinë dhe vetitë e kësaj force nga fenomeni dhe ta zbatojmë çka zbuluam në shembuj të thjeshtë si principe me anë të të cilëve, në mënyrë matematike, të mund të vlerësojmë efektet e saj në raste më të ndërlikuara”(përkthimi i autorit).
Pra në qendër të matematizimit është veçimi nga konteksti konkret si një objekt ideal (në kuptimin produkt të mendjes sonë) një raport, një figurë gjeometrike etj. me të cilin ne operojmë me mjetet matematike si relacione, ekuacione etj.

Është e njohur nga të gjithë se cikli i zgjidhjes së një problemi me kontekst real kalon në 5 etapa si:
a. veçimi i të dhënave të problemit;
b. shprehja e tyre me terma matematike dhe identifikimi i koncepteve që duhen përdorur;
c. Idealizimi i problemit duke mënjanuar mbulesën konkrete, përgjithësimi, bërja e supozimeve dhe shndërrimi i problemit real në një problem matematik;
d. Zgjidhja e problemit matematik;
e. Ballafaqimi i zgjidhjes matematike me kuptimet reale të saj. Gjetja e kufizimeve të kësaj zgjidhjeje. Dhënia e përgjigjes me termat reale.

Secila nga hallkat kërkon një ushtrim dhe përgatitje të veçantë e cila duhet të garantohet nga kursi shkollor.
Hallka e parë kërkon njohuri dhe përvojë jashtë matematike si nga lënda e fizikës, kimia, biologjia etj. Pra, duhet që problemi të kuptohet dhe të ndjehet nga nxënësi.
Hallka e dytë, kërkon vizatimin e ndonjë skice sqaruese, apo figure gjeometrike, gjetjen e rregullsive apo simetrive dhe të relacioneve të njohura ndërmjet të dhënave që kërkojnë përsëri njohuri paraprake.

Në hallkën e tretë, është e rëndësishme edhe përvoja për të realizuar idealizime të ndryshme dhe njohja e sa më shumë modeleve (izomorf me problemin e dhënë). Mbi bazë të këtyre modeleve të studiuar dhe përvetësuar më parë duke u mbështetur në analogjitë mund të ngrihen dhe supozime.
Hallka e katërt kërkon vënien në punë të gjithë njohurive matematike të cilat programi shkollor i ka në plan të parë. Këtu përfshihen idetë dhe konceptet bazë, manipulimi me ato, zgjidhja e ekuacioneve dhe ndërtimet gjeometrike.
Hallka e pestë ka të bëjë me interpretimin e zgjidhjes dhe bën dallimin ndërmjet “zgjidhjes algjebrike” dhe asaj reale. Të gjitha këto shprehi duhet të pasqyrohen drejt në programet tona të cilat i kushtojnë me pa të drejtë vëmendjen më të madhe hallkës së katërt. Një ndihmesë për këtë qëllim japin sidomos problemet e papërcaktuara(open-end), ku nxënësi është në gjendje të formulojë vetë një ose disa probleme, në saje të disa të dhënave, për më tepër, ai mund të ndryshojë të dhënat. Një vend më vete duhet të zënë edhe problemat me shumë variante zgjidhjesh ku duhet gjetur më optimalja. Të gjitha sa përmendëm më lartë mund të konsiderohen kompetencat që duhet të zotërojë një nxënës i përgatitur për jetën, pa përmendur kompetencat tashmë të njohura si aftësia konjunktive për të menduar dhe gjykuar, aftësia e argumentimit, komunikimi dhe paraqitjet sa më të qarta të rrugës së zgjidhjes e rezultateve si dhe aftësia për të përdorur simbolet matematike e mjete të tjera ndihmëse sidomos ato elektronike për të shpejtuar procesin e zgjidhjes.

***Referencat***


**1. Freudenthal, H., Mathematics as an education task. D. Reidel, Dordrecht, 1973**
**2. Heuvel- Pankuzcen, M., Assessment and realistic mathematics education, Utrecht University, 1996(e-book)**
**3. Dedej, K., Frashëri, A., Matematika 2, Shblu, Tiranë 2003**
**4. Dedej, K., Frashëri, A., Rrapo, S., Koci, E. Matematika 3, Shblu, Tiranë 2004**
**5. Dedej, K.,Frashëri, A., etj Fletë pune (Matematika 3) Shblu, Tiranë 2003**
**6. Llambiri, S., Ballhysa, S., Frashëri, A., Matematika 7, Shblu, Tiranë 2002**
**7. Llambiri, S., Papdhopulli, E., Koci, E., Matematika 8, Shblu, Tiranë 1995**
**8. Prifti, I., Mustafaj, F., etj Fizika 7, Shblu, Tiranë 2002**
**9. PISA-2003, Assessment frameëork, Botim i OECD**
**10. Shkurti, A., Spahia, S., Matematika 6, teoria, Shtëpua botuese”Udha e shkronjave” Tiranë 2005**




# Mbi misionin dhe veprimtarinë e Inspektoratit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar (IKAP)

Robert GJEDIA - IKAP

Inspektoriati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar (IKAP) u krijua me VKM Nr. 56, datë 03.02.2010, "Për krijimin e Inspektoratit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar"
IKAP është institucion i posaçëm i inspektimit, monitorimit, vlerësimit e këshillimit të cilësisë së arsimit parauniversitar dhe funksionimit të strukturave menaxhuese të tij si shkolla, drejtori arsimore rajonale, zyra arsimore. IKAP varet drejtpërdrejt nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
Ky organizëm inspekton, monitoron, vlerëson, këshillon dhe nxjerr përfundime mbi zhvillimin e procesit mësimor-edukativ, menaxhimin e bazës materialo-didaktike të shkollës; verifikon pajtueshmërinë e veprimtarisë të institucioneve arsimore me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, udhëzimet e ministrit të Arsimit dhe Shkencës për DAR/ZA-t dhe për institucionet shkollore.

**Gjithashtu IKAP:**

- Monitoron problemet që paraqiten në shkollë me tekstin shkollor;
- Monitoron zbatimin e dispozitave normative të shkollës, kodit të etikës së mësuesit, punën e bordit të shkollës si dhe të organeve demokratike të saj;
- Inspekton zbatimin e rregulloreve të maturës shtetërore dhe provimeve të lirimit.

**IKAP përbëhet nga:**

- Drejtoria e Inspektimit të Kurrikulës dhe Cilësisë
- Drejtoria e Inspektimit të Mbikëqyrjes Institucionale dhe ligjshmërisë
- Sektori i Shërbimeve

**Deri më tani janë hartuar dhe vënë në zbatim:**

- Rregullorja institucionale e IKAP
- Përshkrimet e punës për specialistët/inspektorët
- Është në proces rekrutimi i specialistëve mbështetur në kriteret profesionale dhe në procedurat e Kodit të Punës (i ndryshuar)

**Sipas kësaj rregulloreje funksionet e IKAP janë:**

- Vlerëson cilësinë e shërbimit të institucioneve arsimore. (Funksioni vlerësues)
- Kontrollon pajtueshmërinë e veprimtarive të institucioneve arsimore me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. (Funksioni kontrollues)
- Jep këshilla për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të institucioneve arsimore. (Funksioni këshillues)
- Informon/raporton rreth gjetjeve të tij (Funksioni informues/raportues)

**Llojet e inspektimit do të jenë:**

- I orientuar (I fokusuar tek provimet e lirimit, të maturës shtetërore, të teksteve, të mjeteve didaktike, të problemeve të ndryshme që mund të dalin në proces etj .Ky është një lloj inspektimit që zhvillohet përditë ose çdo javë)
- Tematik (I fokusuar në problematika dhe interesa të posaçme dhe specifike që identifikojnë nevoja dhe probleme për përmirësime të mëtejshme. Ky lloj inspektimit është më i shpeshtë, realizohet çdo vit)
- I plotë (I fokusuar në funksionimin tërësor të një institucioni arsimor. Ky është një inspektim më i rrallë dhe zakonisht aplikohet 1 herë në 3-4 vite )

**Produktet e Inspektimit janë:**

- Raportet e inspektimit, sipas llojeve përkatëse
- Letrat informuese
- Raporti vjetor i IKAP

**IKAP po përgatit në proces produktet e mëposhtme për punën e tij, si:**

- Udhëzuesi i inspektimit të shkollës
- Udhëzuesi i inspektimit të DAR/ZA-ve
- Standardet e inspektorit
- Fjalori i inspektimit
- Plani afatmesëm i zhvillimit profesional të specialistëve të IKAP
- Faqja e internetit e IKAP

**Në kuadër të projektit "C.B.A" IKAP ka zhvilluar deri më tani:**

- Vizitë studimore në Inspektoratin Belg, ku ka përfituar mjaft përvojë bashkëkohore në drejtim të inspektimit
- Është përzgjedhur një konsulencë e huaj për mbështetjen profesionale të IKAP
- Është punuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe on-line me konsulentin e Bankës Botërore për përgatitjen e instrumenteve standard për vlerësimin e kurrikulës së zbatuar në arsimin 9-vjeçar.

Gjatë periudhës maj-shtator 2010 ky institucion ka inspektuar dhe monitoruar në të gjitha DAR/ZA zbatimin e udhëzimeve dhe rregulloreve të MASH që lidhen me maturën shtetërore, provimet e lirimit, monitorimin e shpërndarjes së teksteve shkollore, probleme të ndryshme në shkolla të vendit për specifika dhe ankimime, si dhe ka dërguar 2 letra informuese në çdo DAR/ZA për përmirësimin e mëtejshme të problemeve të identifikuara për provimet e lirimit dhe procesit të përzgjedhjes së teksteve shkollore.

Gjatë vitit të ri shkollor, IKAP bazuar në Udhëzimin e fillim vitit të MASH, do të ndërtojë marrëdhënie të ngushta pune me çdo DAR/ZA për të realizuar planin e punës të miratuar nga Ministri i Arsimit i Shkencës por dhe sipas prioriteteve që MASH ka për këtë vit mësimor.
IKAP përmes revistës "Mësuesi" do të informojë në vijimësi të gjitha grupet e interesit si: mësues, drejtues shkolle, specialistë të DAR/ZA-ve, të MASH, shkolla publike dhe jopublike për gjetjet dhe nevojat për përmirësim të mëtejshëm të procesit të zbatimit të kurrikulës dhe të zbatimit të ligjshmërisë në shkolla dhe në DAR/ZA.

# Këshilla për vitin e ri mësimor

## *Mësuesve dhe nxënësve të shkollës së mesme për Gjuhën shqipe dhe Letërsinë*

**Adriatike LAMI - AVA**

***Sapo ka nisur viti i ri mësimor, vit i cili vjen menjëherë pas sfidave të Maturës Shtetërore, ku mijëra maturantë iu nënshtruan provimeve për matjen e njohurive të tyre. Tashmë, është bërë e zakonshme që gjithmonë flasim për një proces kur një brez e ka kaluar atë dhe nuk i shërben më atij. Nisur nga kjo e quaj të udhës që maturantëve dhe mësuesve të tyre t'u shërbehet me disa këshilla të thjeshta që mund të merren në konsideratë gjatë këtij viti mësimor.***

Natyrisht, që për këto jam mbështetur në punën gjatë hartimit, vlerësimit dhe rezultateve të testeve të Maturës Shtetërore, në lëndën e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë.

Procesi i vlerësimit të testeve nxjerr në dukje më shumë sesa secili prej nesh mund të mendojë. Aty është gjithë sistemi i shkollimit dhe i inteligjencës së strukturuar të nxënësit.

Më duhet të konstatoj se tashmë Matura është konsoliduar. Kjo jo vetëm në aspektin teknik dhe profesional të hartimit të testeve, por edhe në mentalitetin e nxënësit dhe të mësuesit mbi këtë mënyrë vlerësimi që mbart me vete standardin dhe njëmendësinë për sistemin e informacionit që mbetet nga ajo që ka studiuar një nxënës.

Të metat e reflektuara nga kjo punë unë po përpiqem t'i sjell këtu në formën e këshillave që nxënësit dhe mësuesit e tyre duhet t'i kenë parasysh në punën e këtij viti mësimor.

Ja, çfarë mund të bëni për gjuhën dhe letërsinë:

*1- Bëni në fillim të vitit shkollor një minites, ose test provë për të parë se ku jeni me njohuritë .*
Nuk është e nevojshme që të vlerësohet me notë, por të shihet volumi dhe cilësia e informacionit dhe njohurive).

*2 - Përcaktoni një listë librash të detyruara që duhet medoemos t'i lexoni.*

Ju nuk mund të bini preh e gjoja pamundësisë për të lexuar10 vepra të detyruara.Të lexuarit në kohë dhe me kohë ndihmon kujtesën dhe renditjen e analizave që ju do të bëni gjatë vitit, pavarësisht autorit të radhës.

*3 - Mësoni të punoni mbi fragmentin*

Ju nuk mund të bini më preh e shprehjes: Nuk e kam lexuar këtë fragment. Shumë nxënës janë të aftë të flasin në përgjithësi mbi veprën, apo veçanërisht mbi fragmentin. Është e nevojshme që vepra të dalë nga fragmenti dhe fragmenti të lidhet me veprën, pavarësisht pavarësisë personale që kanë.

*4 - Punoni të rendisni njohuritë.*

Njohuritë renditen sipas kronologjisë, sipas rrymave letrare, sipas autorëve, brenda një vepre dhe brenda një fragmenti. Ky shkallëzim zbritës duhet të konceptohet si model nga mësuesi dhe nga nxënësi).

*5 - Mësoni të lexoni dhe të kuptoni një pyetje.*

Shumë nxënës e gjejnë veten të përfshirë në një përgjigje të gabuar pasi nuk kanë mundur të kuptojnë drejt pyetjen pasi nuk e kanë kuptuar atë. Kjo nuk është e lidhur vetëm me mënyrën e tyre të të mësuarit, por edhe me mënyrën e të dhënit të njohurive nga teksti dhe nga ndërmjetësi midis tij dhe nxënësit që është mësuesi.

*6- Punoni me konceptet kyçe.*

Midis morisë së madhe të informacionit gjuhësor dhe letrar, disa prej tyre janë të domosdoshme dhe janë universale.

*7 - Mësoni t'i përgjigjeni vetëm pyetjes.*

Shpeshherë ne japim përgjigje jo të duhura, ose na duhet shumë kohë për të arritur te përgjigja e duhur. Duhet të mësohemi të përgjigjemi vetëm për atë që na kërkohet në një pyetje.

*8 - Punoni hap pas hapi me shkrimet funksionale.*

Shkrimi funksional nuk fillon dhe nuk mbaron me esenë. Pa ditur se si formulohet një paragraf, një përmbledhje, një përshkrim i shkurtër, një minianalizë nuk mund të pretendojmë një strukturë perfekt të esesë së plotë. Edhe vetë brenda esesë duhet të punohet me llojet e ndryshme të saj. Shpesh gjejmë raste që megjithëse është dhënë ese argumentuese, aty gjejmë ritregim, ose megjithëse është dhënë ese përshkruese, aty gjejmë vetëm elementë të një argumentimi të thjeshtë. Për të mos folur më pas për esenë krahasuese, e cila nuk mund të konceptohet pa pasur përballë dhe pa njohur mirë dy objekte, dy personazhe, dy mjedise, etj.

*9 - Ripunoni çdo gjë që shkruani.*

Pasi shkrimi funksional realizohet ai duhet ripunuar disa herë. Është defekt i procesit që në shumicën e rasteve bëhet një punim, merret një vlerësim dhe nuk ribëhet duke reflektuar të metat e vështruara.

*10 - Pastaj provoni një model testi të AVA.*

Të mësuarit me modelin është mënyrë efikase për të pritur rezultate të mira. Me modelet nxënësit mund të merren edhe individualisht meqenëse për secilin prej tyre kanë edhe skemat e përgjigjeve.



# Ora e mësimit është "laborator"

Nga Isa FERIZAJ

Shkolla është "laboratori" më i rëndësishëm e i domosdoshëm, në të cilin duhet të kalojë domosdoshmërish çdo njeri. Shkolla, si një pjesë e rëndësishme e jetës së njeriut, nuk mund të jetë gjë tjetër veçse një etapë e veçantë me shumë vlera, një sekuencë e "eksperimentit" të madh të jetës së çdo njeriu, në të cilin ka gjithmonë dy palë që eksperimentojnë njëra-tjetrën. Këto dy palë janë: njerëzit, nga njëra anë dhe jeta, në anën tjetër.
Me qenë se shkolla ka mision që të përgatitë qytetarin e ardhshëm, të aftë për t'u përballë me çdo sfidë të jetës, apo të aftësojë atë që të "ecë" vetë për t'i dhënë vlera jetës e shoqërisë, mendoj se të mësuarit në shkollë, pra mësimi i dhënë tradicionalisht brenda njësisë klasike kohore, që është ora e mësimit, e, për rrjedhim kjo e fundit meriton një përqendrim vëmendje e, pse jo, edhe të një harxhimi energjish më të mëdha, për ta parë atë si "laboratorin" e vërtetë, ku dy palë, si në jetë, edhe eksperimentojnë, edhe eksperimentohen, pra nxënësit dhe mësuesit me shumëllojshmërinë e teksteve e të përmbajtjeve të tyre, me botën, ndjenjat, gjykimet, metodat, mjetet, qëllimet e përvojat e tyre jetësore.
Ora e mësimit është pra, "laboratori" ku eksperimentohen në çdo etapë të saj, botët shpirtërore të nxënësve, me kompleksitetin e ndërlikuar të ndjenjave që kërkojnë të formohen dhe të orientohen drejt. Mirëpo një orë e tillë "laborator", mund të konceptohet edhe "laboratori" në të cilin provohen aftësitë, shkathtësitë, e shprehitë e fituara në punë, por edhe përgatitja e vazhdueshme koherente e çdo mësuesi. Ora e mësimit "laborator" ka edhe përfundimet e saj shkencore, në lidhje me atë që "eksperimentohet" brenda dyzet e pesë minutave. Një orë e konceptuar e tillë, formon ndjenja të reja, konsolidon njohjen e mëparshme dhe nxit mendjen për të kërkuar përtej asaj që njihet, apo shikohet. Një mësues i vërtetë nuk mund të futet në një orë mësimi të tillë pa përcaktuar që më parë një platformë për atë që do të "eksperimentojë" e, se në çfarë përfundimesh do të arrijë në fund të "eksperimentit". Në qoftë se një mësues do të futej në një orë mësimi me idenë se vetëm ai do të kryejë një eksperiment, duke qenë "lëndë" e atij eksperimenti nxënësit, ai nuk është i përgatitur për atë orë mësimi, pra as për "eksperimentin" e tij. Brenda kohës së orës së mësimit ndodhin tërë ato procese, psikologjike, emocionale, etj, si tek nxënësit edhe tek mësuesit. Është e domosdoshme që mësuesi t'i njohë këto procese e të dijë t'i përdorë në shërbim të "eksperimentit". Ka shumë rëndësi që mësuesi duhet të kuptojë se ai vetë "eksperimentohet" brenda një ore mësimi nga nxënësit e vet. Jo rrallë herë na ka rastisur të dëgjojmë nga nxënës të ndryshëm, vlerësime nga më të ndryshmet për mësuesit e tyre. E, qoftë vetëm ky fakt, mjafton të kuptojmë se çdo mësues, në çdo orë mësimi "eksperimentohet" nga nxënësit e vet.
Një orë mësimi është njësia bazë e të mësuarit klasik në shkollë, por ky proces tashmë ndodh edhe jashtë një organizimi të tillë kohor. Një orë mësimi ka gjithmonë seriozitetin e të dyja palëve, nxënësve dhe, mësuesve, çka e kthen atë në një "laborator" të vërtet kohor.
Çdo orë mësimi, ashtu si shkolla në tërësinë e vet, ka si qëllim që të ngrejë në nivelet më të larta mendjet e nxënësve. Por që të realizohet ky revolucionarizim i mendjes, duhet njohur shumë mirë bota shpirtërore e nxënësve, por edhe e mësuesit. Vendosja e raporteve të drejta në njohjen midis mendjes dhe zemrës e lehtëson shumë "eksperimentin" në orën e mësimit. E, detyra e parë për përcaktimin e vendosjen drejtë të këtyre raporteve, kuptohet se është e mësuesit, por pa menduar kurrë se edhe nxënësit nuk e kanë bërë edhe ata një gjë të tillë, në mënyrën e të kuptuarit të tyre, qysh më parë.
Në një orë mësimi, ashtu si në jetë, ka gjëra që duken, por gjithmonë ka më shumë nga ato që s'duken e, që presin që të nxirren në dritë, për t'u parë, prekur e ndjerë. Pikërisht për këtë arsye, mësuesit i del detyra që të thellohet vazhdimisht në "eksperimentin" e tij, me qëllim që t'u japë sa më shumë njohuri nxënësve të vet, duke i bërë ata pjesëmarrës aktiv në të gjitha etapat e ecurisë së një ore të tillë.
Duke u vendosur nxënësit në qendër të orës së mësimit, pra të "eksperimentit" në atë "laborator" kohor, mësuesi i mirë në fund të "eksperimentit" del me përfundime të qarta e të mbështetura, si për nxënësin, ashtu edhe për veten. Njohja e përfundimeve për veten ka shumë rëndësi, pasi ajo mund të shërbejë si një pikënisje për të përsosur më shumë veten edhe si mësues, edhe si njeri.
Në qoftë se analizojmë, për arsye studimi, vetëm palën e mësuesit, bashkë me të do përfshijmë edhe shumëllojshmërinë e teksteve e të përmbajtjeve të tyre, pasi ato janë "lënda" me të cilën "eksperimentojmë", por edhe ato vetë "eksperimentohen". Një mësues që e ndjen, e interpreton materialin lëndor në një orë mësimi, pa dyshim ka zbuluar para nxënësve të vet një botë të panjohur prej tyre, ka zgjuar një larmi ndjenjash e emocionesh, çka është dhe misioni i tij. Një mësues, që "eksperimentin" e vet e konsideron orën e mësimit, arrin në përfundim të saj që të ngrejë më lartë mendjet e nxënësve, por edhe të vetvetes.



Zbulimi i botës së ndjenjave të nxënësve, pra njohja e zemrës e lehtëson shumë "eksperimentin" dhe atë botë të zbuluar dhe të njohur më mirë, një mësues i kujdesshëm e orienton më mirë për ta lidhur në mënyrë organike, pra botën e ndjenjave, me të menduarit, pra me botën e logjikës. Siç vihet re, ndërtimi i marrëdhënieve të drejta e të shëndosha midis nxënësve e mësuesve, është edhe guri i themelit për të nxitur dhe formuar një të menduar të "shëndetshëm", mendimi i cili qëndron shumë më lartë, se sa mund të qëndronte pa këto marrëdhënie.
Është detyrë e çdo mësuesi që të njohë veçoritë psikologjike moshore të nxënësve të vet e mbi bazën e njohjeve të mëparshme të këtyre veçorive, në grup mosha të njëjta, pasi ka nxjerrë përfundime, të dijë të orientojë mendimin, logjikën e nxënësve të sotëm, që pa dyshim qëndrojnë shumë më lart se ajo e moshatarëve të tyre, para disa viteve, drejt horizonteve të reja që hapen vrullshëm para tyre. Për t'ia arritur një gjëje të tillë, mësuesi duhet të ecë në çdo hap me kohën e, t'u përgjigjet kërkesave në rritje që shtrohen nga ajo para tij, për punën e përsosmërinë e saj metodike-profesionale, pa nënvleftësuar atë shkencor.
Në një orë mësimi, e konceptuar si laborator, nuk mund t'i shmangesh përgjegjësisë për suksesin a mossuksesin e "eksperimentimit". Vetëm po ta shikojmë orën e mësimit si një "laborator" ku eksperimentohet gjithmonë për të provuar gjithnjë të vërtetën, dijet, mësuesi i mirë, nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, nxënësi, pse jo edhe prindi, mund të bëjmë vlerësime të drejta, të arsyetojmë mbi bazën e krahasimeve e, arrijmë më lehtë atje ku ka për qëllim, qoftë ora e mësimit, qoftë masa e nxënësve, qoftë trupa mësimdhënëse, apo komuniteti i prindërve të nxënësve të një shkolle.
Stadi nëpër të cilin po kalon shkolla, me tërë kompleksitetin e vet, kërkon të ngrihet në një nivel më të lartë përgjegjësia e përgjegjësive për të, vlerësimi nga struktura shtetërore, nga shoqëria e nga çdo individ, i shkollës, si fidanishtja ku mbillet e formohet shoqëria e ardhshme e kombit. Investimi për shkollimin e shoqërisë, por jo parakalimin masiv të saj nëpër shkolla, si një nevojë e pakuptimtë për të kaluar një pjesë të jetës aty, pa objekt, është detyra më humane e më e madhja e një shteti të përgjegjshëm për fatet e kombit të vet.

# Si të planifikojmë një orë mësimore

*Që plani mësimor ditor të mos mbetet në kufijtë e formales dhe të mos bëhet rutinë e bezdisshme për mësuesin, por të kthehet në një mjet ndihmës në punën dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor, ne si mësues duhet të krijojmë hapësira dhe të planifikojmë veprimtari sa më tërheqëse dhe frytdhënëse.*

**Nikolin GËRMENJI**
**Gjimnazi "Themistokli Gërmenji" - Korçë**

Fjala e parë që të vjen në mendje kur bëhet fjalë për orën e mësimit është "plani mësimor ditor", i njohur në gjuhën e përditshme si "ditari".
Sa herë që bëhet fjalë për "ditarin" apo "planin mësimor ditor", çdo mësues e lidh atë me detyrimin që ka për ta paraqitur në rast kontrolli apo për të qenë në rregull me detyrimin ligjor. Në fakt, plani ditor duhet konsideruar si një mjet ndihmës për mësuesin.
Që plani mësimor ditor të mos mbetet në kufijtë e formales dhe të mos bëhet rutinë e bezdisshme për mësuesin, por të kthehet në një mjet ndihmës në punën dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor, ne si mësues duhet të krijojmë hapësira dhe të planifikojmë veprimtari sa më tërheqëse dhe frytdhënëse.
Plani mësimor ditor duhet të hartohet me qëllimin që përmes tij të komunikojmë veprimtari mësimore të lëndës, të përcaktojmë objektivat, procedurat e punës, materialet dhe mjetet e nevojshme dhe një përshkrim se si do të bëjmë vlerësimin.
Një mësues me përvojë i redukton këto plane mësimore në një hartë apo skicë të shkurtër, ndërsa për një mësues të ri është e domosdoshme një plan i detajuar dhe i plotë.
**Të gjitha planet mësimore fillojnë ose duhet të fillojnë me një objektiv.**
Plani mësimor ditor dhe hartimi i tij është aftësi, si të gjitha aftësitë dhe e tjera dhe fitohet me përvojë.
Gjatë punës së përditshme, jo gjithmonë arrijmë të hartojmë plane ditore të detajuara dhe të sakta. Shpesh planifikimi i orës së mësimit mund të paraqesë gabime apo pasaktësi.
Cilat janë disa nga gabimet tipike që bëjmë në planin mësimor ditor?
a) **Objektivat** - zakonisht, gabimi tipik i të gjitha planeve mësimore është caktimi saktë dhe shkrimi i drejtë i objektivave. Duhet bërë e qartë se një objektiv nuk është një qëllim i temës mësimore apo një kërkesë e informacionit të ri. Një objektiv është përshkrimi i asaj që duhet të bëjë nxënësi, pra një objektiv është një veprimtari nëpërmjet së cilës nxënësi do të arrijë të përvetësojë një aftësi, shkathtësi apo njohuri.
b) **Vlerësimi** - një element i orës së mësimit shumë i rëndësishëm është vlerësimi i arritjeve. Ky element është më i nënvlerësuari apo më i paparashikuari në planet tona mësimore ditore. Për të mos ia lënë vlerësimin subjektivitetit, fiktivitetit dhe rastësisë, është e nevojshme që vlerësimi të mos shihet i veçuar nga objektivat. Vlerësimi në një plan mësimor është një përshkrim i realizimit ose jo të objektivave që kemi vendosur dhe që paraqitet i mishëruar në objektiv.
c) **Metodat e të mësuarit** - shpesh përcaktimi i metodave nuk përshtatet me nivelin e nxënësve. Kjo ka të bëjë me faktin nëse mund të bësh më shumë me të njëjtën energji ose të arrish të njëjtin rezultat me më pak përpjekje. Zgjedhja e metodave lidhet ngushtë me përvojën dhe aftësitë e mësuesit, por është mirë të tregohemi sa më elastikë dhe të guximshëm për të përdorur metoda të reja dhe të jemi në kërkim të metodave sa më efikase. Edhe nëse një metodë nuk na jep atë që dëshirojmë, nuk ka pse të quajmë planifikimin e dështuar. E rëndësishme është të tentojmë, të guxojmë dhe mbi të gjitha të nxjerrim konkluzione rreth punës sonë.
d) **Veprimtaritë** - nëse do të na kërkohej të planifikonim një orë mësimore model, shqetësimi ynë kryesor do të ishte se çfarë do të bënim konkretisht në këtë orë. Harrojmë se ora e mësimit ka një qëllim kryesor: Çfarë do të bëjnë nxënësit gjatë orës së mësimit? Kjo është arsyeja që në planet tona ditore detajohet çdo veprim apo edhe pyetje e jona, duke anashkaluar nxënësit. Çdo veprimtari e orës së mësimit duhet t'i shërbejë realizimit të objektivave mësimore. Është mirë që të mos zhvillojmë veprimtari vetëm sa për të zënë me punë nxënësit.
Si përfundim, mund të thuhet se qëllimi i hartimit të një plani mësimor ditor është të komunikojë. Ai duhet t'u përgjigjet tri pyetjeve të thjeshta:

KUJT? / ÇFARË? / SI?

Çfarë duhet të përmbajë një plan mësimor ditor?
Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje do të doja të paraqisja një format model të një plani mësimor ditor.

**FORMAT I PLANIT MËSIMOR DITOR**

**1. Data**
**2. Lënda:**
**3. Klasa:**
**4. Tema mësimore:**
**5. Objektivat e orës së mësimit:** (përcaktohen çfarë do të mësohet; çfarë duhet të bëjë një nxënës dhe jo një grup nxënësish)
**6. Procedura e orës së mësimit:** ( përshkrimi i asaj që do të bëjmë për të shpjeguar mësimin duke përfshirë edhe një përshkrim të asaj se si do të paraqesim mësimin, çfarë teknikash mësimore do të përdorim dhe si do të përfundojmë mësimin. Zakonisht kjo pjesë e planit mësimor mund të paraqitet me një tabelë skematike si më poshtë.)

| Nr. | Veprimtaritë | Metodat | Koha |
|---|---|---|---|
| 1. | Hyrje | | 5 min |
| 2. | Veprimtari e drejtuar | Punë me grupe | 15 min |
| 3. | Informacioni i ri | Bashkëbisedim | 5 min |
| 4. | Punë e pavarur | Ese | 15 min |
| 5. | Vlerësimi | | 5 min |

**7. Të dhënat paraprake:** (tregojnë çfarë duhet të dinë nxënësit ose duhet të bëjnë në mënyrë që ora e mësimit të jetë e suksesshme. Kjo etapë përfshihet tek hyrja.)
**8. Materiale dhe mjete:** (është mirë që në planin mësimor të parashikohen mjetet dhe materialet mësimore ndihmëse si dhe mënyra e përdorimit të tyre, nëse ato nuk janë mjetet tradicionale të orës së mësimit si p.sh., kur bëhet fjalë për përdorimin e projektorit, mjeteve audiovizuale etj.)
**9. Vlerësimi:** (përshkruhet se si do të përcaktojmë masën e përfitimit të objektivit mësimor nga ana e nxënësve. Kjo lidhet ngushtë me ato detyra që kemi paraqitur në fillim të orës së mësimit.)
**10. Aktivitete plotësuese:** (këtu mund të përshkruajmë veprimtari dhe materiale të tjera për të përforcuar dhe zgjeruar mësimin. Gjithashtu futen detyrat e shtëpisë dhe projekte të ndryshme.)



# Orë model

Mimoza BERBERI
Shkolla 9-vjeçare “Lasgush Poradeci” - Tiranë

**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Klasa:** IX
**Tema:** ”Prilli i thyer” Ismail Kadare
**Objektivat:** Në përfundim të orës së mësimit nxënësi duhet të jetë i aftë që:
- të lexojë për të identifikuar veçoritë e romanit me temë sociale
- të tregojë detajet artistike që ka përdorur autori për të përcaktuar kohën historike dhe kohën e brendshme të rrëfimit
- të hulumtojë mbi fenomenin e gjakmarrjes
- të përshkruajë gjendjen shpirtërore të të dy personazheve; Djanës dhe Gjorgut

Konceptet kryesore: prill, i thyer

| struktura e mësimit | | | |
|---|---|---|---|
| fazat e strukturës | strategjitë mësimore | veprimtaritë e nxënësve | organizimi i nxënësve |
| parashikimi | diskutim për njohuritë paraprake | diskutimi i ideve | punë me klasën |
| ndërtimi i njohurive | rolet e specializuara | ndërtimi i shprehive | punë me grupe |
| përforcimi | shkrimi i shpejtë | nxitje për të përsosur të shkruarin | punë individuale |

**Parashikimi:** diskutim për njohuritë paraprake
Para nxënësve shtrohet pyetja: Si e imagjinoni ju Shqipërinë e viteve 30?
Nxënësit japin mendime të lira p.sh
- të varfër e të mjerë;
- malësori migjenian duke mbledhur kokrrat e misrit;
- shteti me në krye Mbretin Zog pati një farë lulëzimi,
- rol kishte feja
- mungesa e shtetit dhe vendosja e vetëgjyqësisë, sidomos në Veri

**Ndërtimi i njohurive:** role të specializuara
**1-historianet;** përcaktoni përmes detajeve artistike kohën historike dhe kohën e brendshme të rrëfimit, koha historike; ajo kishte lexuar e dëgjuar aq shumë kur studionte në institutin e vajzave “Nëna Mbretëreshë” e sidomos më pas gjatë kohës që ishte fejuar me Besjan Vorpsin (këtu jepet me e plotë panorama e viteve 30)
koha e brendshme; koha kur vendosen ngjarjet në rrëfim Kishte vetëm gjysmë ore që i ishte dhënë besa tridhjetëditëshe dhe ai gati po mësohej me idenë se jeta e tij ishte ndarë në dy copa; një copë e gjatë, 26 vjet, një jetë e ngadaltë gjer në mërzi…, kurse copa tjetër e shkurtra, katër-javorja, e vrullshmja, e shpejta si një ortek, vetëm gjysmë mars e gjysmë prill…
**2-gjeografët** Tregoni vendin ku zhvillohet ngjarja? Tregoni si funksiononte në atë vend gjakmarrja?
• Në Veri të Shqipërisë (malësor, orosh, varret e krushqve, rrafshi i Dukagjinit)
• Në mëngën e tij dallohej qartë rubi i zi/taksa e gjakut,… në shtëpinë që kanë për të marrë gjak, varet në një kënd të kullës këmisha e përgjakur e viktimës, e cila nuk hiqet prej andej pa e hequr gjakun…këmisha rri aty ditë e natë, muaj e stinë dhe gjaku ndërron ngjyrë në të dhe njerëzit thonë: -Ja, të vdekurit nuk po i durohet sa të merret haku i tij.
**3-hulumtuesit:** Tregoni fakte rreth Lek Dukagjinit dhe Kanunit të tij.
**4-letrarët:** Përshkruani gjendjen shpirtërore të Gjorgut dhe të Djanës.
-Djana: Zhgënjimi që pëson paradoksi midis jetës në Tiranë dhe asaj që kishte lexuar në një anë dhe nga ana tjetër, realitetin e vrazhdë, të zbehtë që gjeti aty.
-Gjorgu, midis dilemës qe nisur për t’u ngujuar, por shikon Djanën, si zanë të bukur, një malësor të ri që hakmarrja e vjetër e detyroi të bëhej vrasës. Duhet një vullnet prej titani që të nisesh drejt vdekjes, sipas një urdhri të marrë prej një largësie tepër të madhe. E, ç’janë lëkundjet e Hamletit përpara mëdyshjeve të këtij Hamleti të malësive tona.
**5- interpretuesit:** Interpretim i improvizuar i fragmenteve me personazhet kryesore: Djana, Gjorgu, Besjani.
- E ulur në një karrocë (e improvizuar me banka) me sytë e ngulur drejt Gjorgut, u zgjodh një vajzë e bukur me sy të mëdhenj.
-Shkrimtari me letër e laps në dorë
-Djali malësor (futi pantallonat në çorape, gjeti një jelek, kapuçi në vend të qeleshes.
**6-përforcimi:** Shkrim i shpejtë, prilli, i thyer

***Pranverë. Ecte mes barit të sapo dalë dhe aromës së luleve të sapo çelura. I gjatë, siç janë në përgjithësi malësoret, me shikimin e mprehtë prej të riu qe nuk i shpëton asnjë detaj i natyrës dhe kohës, i zbehtë prej asaj që përjetonte. Papritur, përpara i del një zane e bukur. Kishte dëgjuar nëpër legjenda për bukurinë e tyre, por nuk ia mori mendja se do magjepsej aq shume pas saj. E ndoqi, por përnjëherësh u step. Qëndroi si i ngrire aty midis dy rruginave: Herë shikonte nga zana e herë nga shtëpia. Jo, e bukura e tërhoqi pas vetes e shijoi atë bukuri, porvetëm për pak...***

**7-vlerësimi i nxënësve,** u bë në bazë të:
• pjesëmarrjes aktive në diskutim,
• aftësive për të klasifikuar materialet,
• interpretimit filozofik të pjesës dhe personazheve
• aftësia për të analizuar një tekst nga ana letrare dhe sociale
• si i zhvilloi më tej idetë

**Nga përvoja nxënësit ndihen të përfshirë në orën e mësimit, marrin pjesë në diskutime, interpretime dhe argumentim të lirë.**



# Roli i mësuesit në vlerësimin e jashtëm të kurrikulës

**Antoneta RAMAJ - IKAP**



***Kushti i parë* dhe i rëndësishëm për çdo mësues është njohja në detaje e programit, në të gjitha elementet përbërëse të tij. Sqarojmë se teksti i nxënësit, apo tekste të tjera shtesë shërbejnë si burime informacioni për realizimin e programit. Njohja dhe të kuptuarit e programit ndihmon mësuesin të përzgjedhë saktë tekstin dhe literaturën tjetër ndihmëse, që do të përdorë apo do t'ua rekomandojë nxënësve.**

Drejtoria e Inspektimit të Kurrikulës dhe të Cilësisë pranë IKAP-it ka në fokus të saj edhe vlerësimin e jashtëm të kurrikulës. Kjo, padyshim, e bën të domosdoshme "prekjen" nga afër të kurrikulës së zbatuar në shkollat tona.

*Një kurrikulë mund të jetë e shkruar mirë, por suksesi i saj varet nga mënyra sesi zbatohet ajo.*

Dihet që drejtuesi dhe menazheri i procesit mësimor është mësuesi. Ai ka në "dorë" kurrikulën e shkruar dhe nxënësin. Është detyra e tij "të luajë" me këta dy aktorë dhe gjithashtu, është aftësia e tij nëse ua lehtëson apo vështirëson lojën aktorëve. Roli i mësuesit në vlerësimin e kurrikulës është i rëndësishëm, pasi ai është personi i vetëm që zbaton në kushtet e shkollës, drejtpërdrejt me nxënësit, kurrikulën e shkruar.

Ka mëse një vit që edhe arsimi i mesëm punon me kurrikulat e reja, të cilat janë një konceptim i ndryshëm nga të mëparshmet. Për këtë është e domosdoshme që mësuesit të njohin dokumentet zyrtare, si: korniza kurrikulare, standardet e fushës së të nxënit dhe programet lëndore.

1. Programi lëndor është *detyrim ligjor* për çdo mësues, gjë që nënkupton se të gjitha kërkesat e shkruara në të, duhen zbatuar. *Kushti i parë* dhe i rëndësishëm për çdo mësues është njohja në detaje e programit, në të gjitha elementet përbërëse të tij. Sqarojmë se teksti i nxënësit, apo tekste të tjera shtesë shërbejnë si burime informacioni për realizimin e programit. Njohja dhe të kuptuarit e programit ndihmon mësuesin të përzgjedhë saktë tekstin dhe literaturën tjetër ndihmëse, që do të përdorë apo do t'ua rekomandojë nxënësve.

Gjithashtu, mësuesve u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënit dhe të gjitha programet lëndore të të njëjtit vit, pasi integrimi ndërlëndor e kërkon këtë, për t'u bërë më efikas. Jo vetëm kaq, po ai duhet të njohë edhe programet lëndore të lëndës për klasën paraardhëse dhe klasat pasardhëse.

Natyrshëm lind pyetja:

**-Çfarë duhet të dijë një mësues nga programi lëndor?**

Është e domosdoshme njohja e misionit të lëndës, synimit, parimeve mbi të cilat është ndërtuar, e përmbajtjes që do të thotë se çfarë do të përfitojë nxënësi, si dhe kriteret e rekomandimet që mundësojnë realizimin e plotë të programit.

Të gjitha këto duhet të studiohen nga mësuesi, para se ai të hartojë planin vjetor.

Kështu, nëse mësuesi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë 10 e ka të qartë se programi lëndor është ndërtuar mbi parimin e integrimit të gjuhës shqipe dhe të letërsisë, atëherë ai nuk i trajton këto si dy lëndë të ndara, por si një të tërë. Kjo do të thotë që brenda orës së mësimit duhet të zhvillohen të pesë aftësitë: të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit, të lexuarit dhe të vështruarit, pavarësisht se cila prej tyre ka peshë specifike më të madhe. Pra, ***nuk ka orë mësimi ku nxënësi vetëm ushtron të folurit apo të shkruarit, të lexuarit apo të vështruarit.***

Po kështu, respektimi i parimit të rimarrjes, një tjetër parim që përshkon lëndën, kërkon që mësuesi të jetë i mirëinformuar me atë që nxënësi ka përvetësuar në vitet e mëparshme. Është e domosdoshme që ai të përcaktojë të njohurën dhe të panjohurën për nxënësin. E thënë më qartë, të përcaktojë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet të cilat nxënësi i ka përfituar në vitet e mëparshme të shkollimit, si dhe ato me të cilat do të njihet për herë të parë. Nëse ndodh kjo, mësuesi nuk e trajton, p.sh.: konceptin e tekstit sikur nxënësi përballet me të, për herë të parë në klasën e 10-të. Ai vlerëson njohuritë që ka marrë nxënësi për këtë koncept dhe e vazhdon punën, duke i zgjeruar më tej njohuritë dhe në një shkallë më të lartë vështirësie.

Të njëjtën gjë mund të themi edhe për figurat letrare, si: metafora, krahasimi, epiteti etj., me të cilat nxënësi është njohur më parë. Mirëpo, ajo që duhet të bëjë tani mësuesi është t'i trajtojë këto figura në kontekste të ndryshme, më komplekse dhe për qëllime të ndryshme. Kjo rrit njohuritë dhe aftësinë e nxënësit në përdorimin e tyre në të shkruar apo në të folur.

Parimi i rimarrjes është shumë i rëndësishën për lëndën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë. Ai është i lidhur me vetë specifikën e kësaj lënde ku njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet përftohen në proces dhe jo si të marra një herë e përgjithmonë. Ndaj, njohja dhe respektimi nga mësuesi i këtij parimi është i domosdoshëm për të kuptuarit dhe të konceptuarit saktë të lëndës.

*Kushti i dytë* i rëndësishëm është njohja deri në "familjarizim" i përmbajtjes së lëndës. Tashmë, përmbajtja e lëndës jepet me anë të objektivave. Kjo i ndihmon mësuesit të përcaktojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që do të përfitojnë nxënësit brenda një ore mësimi, njësie mësimore, semestri a viti shkollor.

*Kushti i tretë* është respektimi i kritereve dhe i rekomandimeve të ndryshme që jepen në program. Kështu, në lidhje me përzgjedhjen e fragmenteve a veprave duhet të respektohet parimi gjinor, duke filluar nga periudha më e hershme, sigurisht, duke marrë parasysh përqindjet për çdo gjini. Gjithashtu, kërkohet që çdo tekst të punohet jo më pak se 3 orë dhe çdo vepër e plotë jo më pak se 6 orë. Ajo që ka rëndësi në këtë pikë është se punimi i veprës së plotë të një gjinie të caktuar, duhet të bëhet pasi të jenë punuar fragmentet e përzgjedhura të së njëjtës gjini. Kjo për arsye se njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e përftuara nga pjesët e përzgjedhura do të transferohen në një kontekst të ri, më të plotë dhe padyshim më kompleks. Pra, kalohet nga pjesa tek e tëra, duke bërë tranferimin dhe jo riprodhimin e njohurive, aftësive, qëndrimeve (do të ishte gabim nëse do të vepronim ndryshe!!!).

2. Plani vjetor, si një dokument tjetër i rëndësishëm, është zbërthimi dhe materializimi i programit, duke e bërë këtë të fundit më konkret e më të prekshëm. Pavarësisht se çfarë libri



përzgjedhet për të punuar, planet vjetore në shkolla dhe rrethe të ndryshme duhet të zhvillojnë të njëjtat njohuri, aftësi e qëndrime tek nxënësit. Dihet se në përfundim të arsimit të mesëm, nxënësit do të përballen me të njëjtin test vlerësimi. Dhe, është programi ai që e përcakton këtë detyrim.
Hartimi i planit vjetor duhet të bëhet pasi të jenë të qarta të gjitha dokumentet e lartpërmendura që lidhen me lëndën dhe klasën.
**Planit vjetor duhet të hartohet nga vetë mësuesi!** Nuk duhet të përdoren plane të parapërgatitura nga të tjerë, ku mësuesi nuk është i përfshirë në këtë proces. Nëse do të ndodh kjo, atëherë mësuesi do ta ketë të vështirë planifikimin ditor dhe shpesh do të gjendet përballë situatave të paqarta. Tek plani vjetor duhet të jetë e pasqyruar gjithçka që është e parashtruar në program.

3. Plani ditor ose ndryshe përgatitja ditore e mësuesit është detajimi dhe konkretizimi i planit vjetor. Një nga pikat e rëndësishme të planit ditor është përcaktimi i objektivave mësimor (objektiva specifikë). Kjo është pikënisja e gjithë punës përgatitore.
Dihet se në program, përmbajtja e lëndës jepet me objektiva, të cilat tregojnë nivelin më të lartë të arritjeve brenda atij viti shkollimi. Është detyrë e mësuesit që të paraqesë në planin ditor nivelin bazë e të mesëm të objektivave që do të realizohen brenda orës së mësimit. Kjo do ta ndihmojë atë për të planifikuar hapat dhe për të përcaktuar metodën e realizimit të tyre.
Metodologjia, teknikat dhe strategjitë e përzgjedhura nga mësuesi për të realizuar mësimdhënie/nxënien janë një faktorë i rëndësishëm në zbatimin e kurrikulës së shkruar.



Nëse do të njihen mirë nga mësuesi dokumentet zyrtare të kurrikulës, nëse do të përdoren metoda bashkëkohore për realizimin e tyre, atëherë themi se është një fillim i mirë i punës për zbatimin e kurrikulës dhe më tej për vlerësimin e jashtëm të saj.

# Diplomat e para të universitetit "Sevasti dhe Parashqevi Qirjazi"

Këto ditë, në sallë e teatrit të Akademisë së Arteve, u zhvillua ceremonia e dhënies së diplomave të para të për studentët e universitetit S&P Qirjazi, pas katër vite studimesh ne programet kryesore të shkencave ekonomike e sociale, në mëse 16 programe studimi të akredituar tashmë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
Në këtë takim celebrues, të financierëve e drejtues biznesesh të së nesërmes, merrte pjese edhe zëvendës ministria e Arsimit dhe Shkencës zonja Nora Malaj.
Në fjalën përshëndetëse për këtë event të tyren, Rektori i këtij universiteti zoti Stefan Qirici, përmes emocioneve të shumta, bëri një bilanc të punës katërvjeçare të kësaj vatre të dijes, tejet konkurrues në tregun e arsimit të lartë, dhe shënoi njëkohësisht, objektivat dhe synimet për të ardhmen.
-Universiteti ynë, - tha midis të tjerave zoti Qirici,- falë një strategjie menaxhimi dhe zhvillimi, të mbështetur mbi cilësinë e shërbimit të ofruar studentëve dhe jo mbi grantet përfitituese prej tyre, po promovon sot ekonomistet më të rinj të këtij vendi, të cilët do synojnë tregun e punës, me sjellje e qasje të reja filozofike e menaxhues për vendin dhe familjet e tyre, fale dijeve që kanë përfituar në auditorët e këtij universiteti.
Të drejtuar nga një staf akademik i përkushtuar me mbi 150 pedagogë të gradave të ndryshme, dhe nga një mbështetje e pakursyer e vetë themeluesit të këtij institucioni, zotit Robert Dakos, një nga pinjollët e njohur të arsimit, familjes Qiriazi, ai shprehu besimin se puna e nisur mirë në këtë katërvjeçar, do të konsolidohet tërësisht në të ardhmen.



Ndaj dhe për pedagogë e studentë të këtij universiteti, ishte një ditë e shënuar, celebrimi i rreth 80 diplomantëve të parë, duke qenë të bindur se do të jenë me të vërtetë konkurrues, gjë që e bën këtë staf akademik edhe më kërkues e të impenjuar në të ardhmen për thellimin e cilësisë së dijes.
Në këtë takim festiv përshëndetën edhe pedagogë të stafit akademik si Ylber Bezo, dhe studentë e studente që merituan diploma nderi dhe certifikata për rezultatet e tyre të arritura gjatë studimeve katërvjeçare.
Në fjalën e saj zëvendës ministria e arsimit dhe shkencës zonja Malaj, pasi falënderoi organizatorët për ftesën, u ndaj në përpjekjet që ka bërë dhe po bën MASH në rritjen e cilësisë së arsimit të lartë, dhe shpalosjen e politikave mbështetëse veçanërisht për arsimin e lartë privat edhe me projektligjin e ri për financimin e universiteteve.
-Konkurrenca dhe cilësia është ajo që do na çojë më përpara në shërbimin ndaj rinisë studentore,-tha midis të tjerave zonja Malaj. Për këdo të ri, dita e diplomimit është një ditë e shënuar dhe që mbetet gjatë në kujtesën e tyre. Është një ditë që të motivon për të kapërcyer pragun e jetës rinore me atë të punës dhe familjes.
Më tej pas fjalëve të rastit erdhi dhe momenti festiv ku blicet e aparateve dhe kamerat u fokusuan tek ata, që mbanin mbi supe mantelin e diplomimit, dhe flakërinin në ajër kapelat me shirita të artë: studentët dhe studentet e këtij universiteti me shumë pretendime e synime për jetën.

# Vlerësimi i punës së mësuesit

Elsa BALLIU



***"Strategjia kombëtare e arsimit parauniversitar 2008-2013" jep parimin themelor:***
**"Sistemi arsimor kombëtar shërben si sektor shërbimi, i cili do të pajisë qytetarët e ardhshëm shqiptarë me njohuritë e nevojshme, me aftësitë e shkathtësitë e mjaftueshme, të edukuar dhe të përkushtuar për të realizuar planin kombëtar e zhvillimor të vendit."**

Roli i mësuesit në procesin e formimit të individit të aftë, mbetet mjaft përcaktues. Në kushtet e reja të integrimit euro-atlantik, arsimit i duhet të ndërtojë bazat e të menduarit kompleks, të lidhur me realitetet shpesh të ashpra të jetës praktike. Politikat reformuese synojnë të ngrejnë nivelet sasiore e cilësore të arsimimit dhe edukimit të qytetarëve të ardhshëm, duke i bërë ata realisht të përgatitur dhe të gatshëm të përshtaten më shpejt me kulturat dhe tregjet ndërkombëtare të punës.

Vlerësimi i punës së mësuesve ka rëndësi për sigurimin e cilësisë së arsimit. Reformimi i pagave në përputhje me kriterin e kualifikimit, vjetërsisë në punë dhe indekset specifike financiare, është vendimtar, por rol të rëndësishëm ka dhe vlerësimi plotësues i punës. Stimulimi është një nga mënyrat që siguron nxitje për pjesëmarrje më të plotë në procesin e mësimdhënies. Diferencimi i mësuesve që realizojnë punë më rezultative nga masa tjetër, siguron dy përparësi të rëndësishme:

a-Plotëson gjendjen shpirtërore të mësuesit, motivon veprimtarinë e tij të përditshme, eleminon rutinën dhe vlerëson mundin, përpjekjet e arritjet e vazhdueshme në procesin mësimor.

b- Siguron standard të lartë në procesin mësimor si shembull e përvojë për t'u arritur e tejkaluar nga të tjerët.

Duke vlerësuar situatën konkrete dhe proceset normale të interesave, i u dha ligjërisht vendi i duhur edhe stimulit material, prandaj në paragrafin 5 të nenit 43 të "Dispozitave normative" përcaktohet:

"Mësuesi gëzon të drejtën e stimulit moral dhe stimulit material për PME(Procesin mësimor-edukativ) me nivel të lartë dhe për kontribut me vlerë në fushën e arsimit."

Në përputhje me kushtet e reja të zhvillimit të vendit, stabilitetit ekonomik dhe plotësimin e kërkesave në rritje të shoqërisë për arsimin, po ze vend mendimi për "pagë të meritës". Një zgjidhje e tillë do të rriste efektivitetin e orës së mësimit, do t'i priste rrugën abuzimit me kurset private për nxënësit e tyre, do të pasqyrojë më realisht shkallën e kualifikimit të mësuesve dhe do të krijojë atmosferë nxitëse në mjediset arsimore. Kjo lloj page, e diferencuar, stimiluese, mund të mbështetet në rezultatet e mësuesit dhe të nxënësve, vetëm atëhere kur për vlerësimin e tyre të sigurohen standarde unike të nivelit kombëtar.

"Strategjia kombëtare e arsimit parauniversitar 2008-2013" përcakton si detyrë të kohës:

*"Tërheqja dhe mbajtja në punë e mësuesve cilësorë kërkon që MASH, IKT,në bashkëpunim me grupet e interesit, të studjojnë skema të reja motivimi, të cilat bazohen në rezultatet(meritën) dhe jo thjesht në stazhin e punës. Veprimi i parë që duhet të merret është respektimi i profesionit të mësuesit, duke u përshtatur pagat e tyre me ato të punonjësve civilë".*

Legjislacioni i ri merr përsipër jo vetëm të vlerësojë punën me mjetet më të përshtatshme, duke mënjanuar politizimin e ideologjizimin, por dhe balancon me kujdes elementët emocionalë të stimulit me përfitimin material. Ai merr parasysh tipare të njeriut që drejtohet nga mendimi se përpjekja njerëzore synon lumturinë. Ajo ndjek rrugë të gjatë e të vështirë dhe është e mundshme pas mposhtjes së vështirësive. Shpresa për të arritur këtë lumturi shërben si baza e çdo aktiviteti njerëzor. Puna e individit dhe e gjithë puna kulturore e njerëzimit buron nga kjo shpresë. Njeriu i jep rëndësi plotësimit të dëshirave, pasi ato lindin nga vetë natyra e tij, ajo që ai arrin, ka vlerë, sepse ai e dëshiron atë. Në këtë mënyrë plotëson anë të intresave të shpirtërore, por pashmangshmërisht edhe materiale.

Mësuesi ka hapësirën e duhur dhe liritë e nevojshme në hapa të ndryshme të procesit të mësimdhënies. I janë krijuar mundësitë e zgjedhjes së metodave, ka fituar aftësi të reja për të organizuar hapësirën brenda klasës dhe ia përshtat të mësuarit nevojave individuale të nxënësve.Të gjitha këto te një mësues i niveleve të përparuara, janë premisa të zbatimit të stimujve më të efektshëm në procesin e lodhshëm, por të bukur të përgatitjes së brezit të ri.



# Institucioni i shkollës në kontekstin sociopolitik

Hajdin MORINA

Institucioni edukativo-arsimor i shkollës gjatë gjithë historisë dhe traditës së saj ka qenë në shërbim të shumicës së shoqërisë, në shërbim të përmbushjes së interesave të ndryshme të saj. Në historinë e pedagogjisë janë konstatuar raste kur diktatorë të ndryshëm janë munduar ta instrumentalizojnë shkollën duke e vënë në shërbim të interesave të ngushta, në shërbim të propagandës qëllimkeqe dhe kundër interesave dhe lirisë njerëzore.

Një orientim të tillë, duke përdhunuar misionin fisnik dhe human të saj, i dhanë përkohësisht shkollës Hitleri në Gjermani gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe Çaushesku në Rumani duke regjistruar në shkolla të veçanta të rinj që do të edukoheshin nën frymën e fashizmit dhe të diktaturës për t'i shërbyer pakicës në pushtet dhe për t'u specializuar për kryerjen e akteve dhe veprimeve të llojllojshme që përfshiheshin gjatë torturave të natyrës psikike e fizike që ushtronte mbi "njerëzit e vet" pushteti i diktaturës. Duke e hetuar përparimin dhe ndryshimin që bënte shkolla te njeriu, sistemet shtetërore jodemokratike janë munduar vazhdimisht ta kishin nën kontroll shkollën, sidomos planprogramet shkollore dhe kuadrin arsimor. Në sistemet e tilla shoqërore institucionet drejtuese arsimore kanë funksionuar plotësisht si instrumente në duar të pushtetit politik dhe kanë shërbyer si armë plotësuese për realizimin e qëllimeve diskriminuese dhe asimiluese kundër kulturës dhe zhvillimit të një etniteti të caktuar.

Pas çdo ringjalljeje, pas çdo organizimi dhe veprimi për liri që kanë bërë pjesëtarët e popullit të robëruar, organet e sistemit pushtues, përpos masave të ndryshme policore, kanë marrë në shqyrtim edhe një herë planprogramet mësimore dhe i kanë varfëruar ato duke hequr të gjitha përmbajtjet programore që mund të ndikonin në zhvillimin e mendimit dhe të vetëdijës kombëtare te nxënësit dhe studentët e etnitetit kombëtar që jetonte nën rrethanat e pushtimit.

Një nëpërkëmbje dhe dhunë sistematike e llojit të veçantë është ushtruar mbi shkollën shqipe në Kosovë gjatë të gjitha periudhave nën sundimin e sistemit jugosllav. Në mes dy luftërave botërore shqiptarët e Kosovës kanë mësuar në gjuhën serbe në shkollat që funksiononin në fshatrat dhe qytetet e tyre. Vetëm në kohën e sundimit austro-hungarez (1915-1918) në disa pjesë të Kosovës u hapën shkolla publike ku mësohej në gjuhën shqipe. Këto shkolla u mbyllën nga autoritetet jugosllave më 1919 dhe nuk funksionuan më deri në kohën e Luftës së Dytë Botërore kur u hapën shkolla shqipe në të cilat punuan mësues shqiptarë të ardhur nga Shqipëria. Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore u hapën në Kosovë shkolla shqipe, por në rrethanat e administrimit ushtarak jugosllav nuk u lejua që përmbajtjet programore të shërbenin për ndërgjegjësimin kombëtar të shqiptarëve, as për shijimin e vlerave të tyre etnokulturore. Edhe në periudha të tjera të pushtimit shkolla shqipe dhe planprogramet e saj mësimore nuk i kanë shpëtuar syrit të Beogradit, por gjuha shqipe, kultura dhe historia jonë kombëtare, sado që mësoheshin të cunguara dhe të censuruara, arrinin në njëfarë mase të shpërndanin shkëndijat e zgjimit dhe të veprimit atdhetar për ta ndryshuar gjendjen e popullit dhe të shkollës shqipe. Kjo arrihej falë kompetencës së mësuesve tanë dhe qarkullimit të literaturës letrare e shkencore nga Shqipëria.

Në shoqërinë e sotme bashkëkohore dhe demokratike ka ndryshuar botëkuptimi dhe qasja ndaj shkollës si institucion shumë i rëndësishëm në shërbim të shoqërisë, në shërbim të edukimit dhe përgatitjes së njeriut të së sotmes dhe të së nesërmes.

Në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit 20 dhe në fillimin e shekullit 21, në aspektin global, filloi një interesim, një organizim dhe bashkërendim tjetër i veprimeve për konsolidimin e institucionit të shkollës, për orientimin e saj drejt sfidave bashkëkohore dhe zgjidhjes së problemeve me të cilat ballafaqohet përditë njeriu i sotëm. Filloi një qasje tjetër për shkollën dhe sistemet më të avancuara të arsimit u bënë modele për shtetet me një ekonomi më pak të zhvilluar dhe për vendet në tranzicion. Organizatat botërore dhe shtetet më të zhvilluara të botës krijuan strategji, vunë objektiva afatesh të ndryshme, nënshkruan konventa e dokumente të tjera për zhvillimin e sistemit të arsimit në të gjitha nivelet e tij, duke përfshirë edhe mësimin gjatë gjithë jetës si filozofinë më të avancuar deri më tash për t'iu përgjigjur drejtpërdrejt kërkesave të kohës dhe për ta ndihmuar njeriun që të integrohet në rrjedhat e konkurrencës dhe të mbizotërimit të dijes. Në këtë drejtim japin kontributin e tyre në mënyra të ndryshme mekanizma të fuqishëm ndërkombëtar, siç janë: OKB-ja, BE-ja, SHBA-të, UNESKO-ja, UNICEF-i etj. Veprimet dhe strategjitë e këtyre organizatave dhe shteteve kanë për qëllim bashkërendimin e aktiviteteve të përbashkëta, me qëllim që të gjitha vendet të zbatojnë metodat më efikase për arritjen e rezultateve në fushën e arsimit dhe të gjithë, pa asfare dallimesh, të përvetësojnë produktet e arsimit dhe t'i shfrytëzojnë ato për nevojat e jetës dhe të zhvillimit të tyre. Në këtë drejtim duhet përmendur kontributi i çmueshëm dhe cilësor i Bashkimit Evropian, i cili, nëpërmjet mekanizmave kompetentë, po bën punë dhe po i koordinon veprimet në shërbim të krijimit të një filozofie dhe të një hapësire evropiane të të mësuarit, duke nënshkruar konventa ndërmjet shtetesh dhe duke harmonizuar qëndrimet për strukturime, strategji dhe objektiva të përbashkët në sistemin e arsimit.



*Shkolla 9 vjeçare Malishevë - Kosovë*

Shkolla e sotme moderne është në kërkim të vazhdueshëm të rrugëve të reja për t'iu përgjigjur sa më drejtpërdrejt kërkesave dhe interesave të kategorive të ndryshme shoqërore, tregut të punës, integrimeve dhe zhvillimeve shkencore e teknologjike. Në këtë drejtim shkolla ka nevojë për një liberalizëm, bashkëveprim dhe transparencë më të madhe gjatë marrjes së vendimeve për menaxhimin e saj, hartimin e planprogrameve mësimore, botimin e teksteve shkollore, sigurimin e mjeteve didaktike etj. Organet arsimore të nivelit lokal dhe vetë drejtori i shkollës duhen të kenë kompetenca më të mëdha për hartimin e politikave arsimore dhe për marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me një mësimdhënie sa më cilësore. Bie fjala, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, duke u mbështetur në kriteret e veta dhe në rekomandimet e ekspertëve të institucioneve të ndryshme monetare, çdo komune ia cakton (kufizon) numrin e punëtorëve të arsimit dhe me vite nuk lejon që ky numër të rritet, pa marrë parasysh rrethanat e arsyeshme siç janë: shtimi i numrit të nxënësve nëpër paralele, shtimi i orëve dhe lëndëve të ndryshme mësimore si rezultat i mësimit të reformuar ose i nevojës së komunës për hapjen e drejtimeve të reja në shkollat profesionale, sado që trumbetohet me të madhe se arsimi profesional duhet të jetë në shërbim të kërkesave të zhvillimit ekonomik të komunës. Thonë kaq është buxheti i miratuar për arsim, nuk ka mundësi buxhetore për realizimin e projekteve të ndryshme nëpër shkolla, por arsimtarët, nxënësit, prindërit mund të pyesin se a ka pasur ekspertë që do ta arsyetonin para organeve qeveritare nevojën për rritjen e shumës së buxhetit për arsim në përputhje me kërkesat dhe dëshirat e të gjithëve për një arsim të reformuar, sa

më cilësor dhe sa më afër standardeve bashkëkohore të arsimit të sotëm në Evropë dhe botë, siç shkruhet pa fund nëpër raporte të organeve të ndryshme arsimore të çdo niveli ose siç thuhet pa fund nëpër takime e konferenca të panumërta, nëpër medie dhe nëpër mbledhje të partive politike. Analizat, vlerësimet e ekspertëve të paanshëm, testimet e ndryshme nëpër shkolla, fjalori dhe aftësitë e shumicës së nxënësve tanë flasin për të vërtetën se në arsimin e Kosovës punët nuk janë krejt ashtu siç i kemi fjalët, nuk përputhen punët me fjalët e shkruara nëpër raporte as me fjalët tona para medieve ose kur duartrokasim për fitoret tona në arsim.

Vetë botëkuptimi i sotëm për shkollën nënkupton të vërtetën se nevojitet një organizim gjithëpërfshirës, një investim i drejtë dhe real, një punë e përbashkët për ta bërë shkollën tonë institucion edukativo-arsimor të kohës në të cilën jetojmë. Reforma posa ka filluar dhe nuk realizohet në masën e duhur pa një përkushtim të të gjithëve. Në paralelen e klasës së arsimit të obliguar që muaj të tërë funksionon me më shumë se dyzet nxënës për shkak të moslejimit të organeve drejtuese arsimire e financiare për ndarjen e saj, pra në një paralele me kaq shumë nxënës a mund të realizohet mësimi në masën e duhur, a mund të arrihet zhvillimi dhe formimi shoqëror, intelektual e shpirtëror i fëmijës, ashtu siç kërkon MASHT-i nëpërmjet qëllimeve të planprogramit mësimor? Jo, natyrisht. Qindra shkolla në Kosovë nuk kanë biblioteka, qindra të tjera nuk kanë në hapësirat e tyre asnjë libër të literaturës shkollore, pedagogjike ose shkencore. A mund të merret me mend kjo e vërtetë? Tempulli i librit pa libër brenda!

MASHT për një ngritje sa më cilësore të mësimdhënies e të mësimnxënies ka organizuar dhe organizon trajnime të ndryshme, disa prej të cilave kanë qenë të vlefshme për procesin e reformës, siç janë MNQ, MKLSH, Hap pas hapi etj., por arsimtarëve të trajnuar u mungon literatura e nevojshme pedagogjike, metodike e metodologjike. Arsimtarëve tanë u ofrohet shumë pak ose aspak literaturë nga fusha e Dijes pedagogjike, nga hulumtimet që bëjnë të tjerët në shkencat e edukimit, siç janë: Filozofia e edukimit, Historia e edukimit, Psikologjia e edukimit, Ekonomia e edukimit, Administrimi dhe planifikimi i edukimit, Edukimi krahasues etj.



Në shumicën e shkollave tona nxënësi merr dije në mënyrë mekanike, pa ditur në të shumtën e rasteve të zbatojë njohuritë dhe shkathtësitë e fituara në shkollë, pa ditur të bëjë anlizë, sintezë dhe vlerësim për fakte e informacione që i ofrohen në situata të caktuara.

Qëllimi i shkollës, siç thuhet në mendimin pedagogjik, nuk është vetëm sigurimi i informacionit për punën dhe jetën e gjeneratave njerëzore që kanë jetuar para nesh, por edhe formimi i individit me aftësi krijuese dhe mendim të pavarur e kritik. Kosova ka vënë hapat e vet në këtë rrugë të gjatë. Qëllimi do të arrihet nëse u bashkohen edhe të tjerët arsimtarëve, nxënësve dhe prindërve. E nesërmja është sfidë e madhe.

# Kornizat

*Ese nga Fatmiroshe Xhemalaj / MASH*

Në çdo shtëpi, zyrë që të shkoni do të gjeni korniza të përmasave të ndryshme. Në to janë vendosur piktura, apo fotografi të cilat kënaqin shijet e njerëzve. Këto lloj kornizash janë të dukshme dhe të prekshme. Ato janë realizimi në praktikë i “vendimeve” të marra në kokën e njeriut.

Një tjetër lloj kornizash janë ato që në dukje janë të padukshme. Këto të fundit kanë të bëjnë me marrëdhëniet midis njerëzve, institucioneve, shteteve, vendeve. Historia e kornizave ka lindur që me lindjen e njeriut, pasi njeriu i krijoi ato. Pra, njeriu që kur lindi i vendosi “korniza“ vetes dhe të tjerëve.

Në fillim ato ishin naive, por me kalimin e kohës e deri në ditët tona kornizat u perfeksionuan deri në sofistikim të plotë, aq sa mund të mendojmë se janë të “padukshme” edhe pse janë të dukshme.

Ato janë aq të rëndësishme sa që njerëzit i kanë vendosur ato në “kokë” dhe sipas nevojave i përdorin. Kryeqendra e mbretërisë së tyre është pikërisht te “koka” e njerëzve. Aty ato bëjnë ligjin, përcaktojnë fatet e njerëzve; çfarë ata lejohen të bëjnë e çfarë jo; përcaktohet hapësira e asaj që është e lejueshme dhe e kundërta.

Hapësirat kuptohet nuk janë të njëjta për çdo individë. Kjo varet nga motivi për të cilën krijohet korniza. Individë të ndryshëm kanë kornizat ku janë futur vet dhe korniza ku fusin të tjerët. Sa më e vogël të jetë korniza ku është futur vet akoma dhe më të vogël e bëjnë atë për të tjerët. Ajo që i bashkon individët është se të gjithë kanë korniza për këtë gjë apo për atë gjë, për këtë dukuri apo për një tjetër.

Historikisht dhe fatmirësisht tendenca e punës së kornizave është zmadhimi i hapësirës së tyre. Por, fatkeqësisht akoma në ditët tona hapësira e tyre është e vogël. Njerëzit janë futur në korniza. Ata janë të vëmendshëm dhe të ndjeshëm ndaj zmadhimit të hapësirës së kornizës së tjetrit. Këtë, “ata” s’mund ta lejojnë. Ka individë “rebelë” që tentojnë të zmadhojnë hapësirën e kornizës ku janë vendosur, apo individë super rebelë të cilët pretendojnë t’i thyejnë fare kornizat. Atëherë njerëzit nxjerrin kornizat e tyre si “shpata” për të mos lejuar dukuri të tilla. Në të tilla raste derdhen lot e gjak; rezultati mund të jetë pozitiv; zmadhim i hapësirës së kornizave, ngandonjëherë dhe thyerje e tyre, por edhe negativ, zvogëlim i saj. Kush janë fajtorët? Mos i kërkoni te të tjerët, por tek vetja. Pyeteni veten: A keni korniza? Me siguri që po. Bëni një bilanc, për punën e kornizave tuaja. Sa ato e kanë zmadhuar hapësirën tuaj dhe të të tjerëve? Sa ato kanë shëruar “plagë” ose krijuar “plagë”? Sa, kornizat tuaja, janë ndërthurur me ato të të tjerëve? A mendoni se korniza juaj është më e mira? Të gjitha përgjigjet në fakt do të tregojnë se ju jeni skllav i kornizave tuaja dhe me to mund të skllavëroni edhe të tjerët.

Çlirohuni nga kornizat tuaja. Aty fillon liria juaj dhe e të tjerëve. Atëherë bota do të ndryshojë.

# Roli i prindit në shkollë

*Kur ata zbulojnë se aktivizimi në shkollë i bën të ndjehen mirë me veten dhe me familjet e tyre, duan të aktivizohen sa më shumë. Kjo ndjehet në çdo bisedë me prindërit, gjyshërit e sidomos është e theksuar kur fëmija frekuenton akoma ciklin fillor*

**Përshtati: Anila JORGJI**
**shkolla 9-vjeçare "Skënder Caci" - Tiranë**

**Në shoqërinë e sotme postmoderne nuk mund ta kryesh detyrën e arsimit në qoftë se nuk bashkërendon forcat me të tjerët: bashkëpunimi, partneriteti i përbashkët krijon bashkëpronësinë dhe bashkëpërgjegjësinë. Shkollat e ndara, të mbyllura nuk mund të jenë qendër e ndryshimeve sepse nuk posedojnë as forcën, as energjinë, as kredibilitetin, autoritetin e as përkrahjen e mjedisit të jashtëm, prandaj nuk janë shkolla "efektive", "lëvizëse", "cilësore".** *(Fullan.M. 2010)*

Të qenit prind fillon qysh në lindjen e fëmijës dhe roli që fiton është për mirë ose për keq. Është një punë me kërkesa dhe e ndërlikuar. Kur ata zbulojnë se aktivizimi në shkollë i bën të ndjehen mirë me veten dhe me familjet e tyre, duan të aktivizohen sa më shumë. Kjo ndjehet në çdo bisedë me prindërit, gjyshërit e sidomos është e theksuar kur fëmija frekuenton akoma ciklin fillor. Bashkësia e prindërve që rrethojnë mësuesit e këtyre klasave është e etur për të bashkëpunuar. Interesimi për pjesëmarrje vjen për shkak të dëshirës për kujdes për këta fëmijë në mosha të vogla, ose ngaqë ndërgjegjësimi i prindërve në ndihmë të shkollës është rritur në tërësi. Kjo s'ka shumë ndryshim. E rëndësishme është që ata janë të gatshëm të ofrojnë bashkëpunim. Kjo gatishmëri kërkon menaxhim.
A është vetë mësuesi i aftë ta menaxhojë? Sigurisht që ai ka nevojë për ndihmë. Në praktikën tonë shqiptare, jo se mungojnë krejtësisht përvojat, por ajo çka të ofron kjo traditë s'është aq e pasur, është e paorganizuar dhe e papublikuar, aq sa s'mund të ecësh në një rrugë të shkelur me sy mbyllur. Kujt duhet t'i referohet mësuesi veç ndjesisë së prindit ? (nëse është i tillë) Studimet botërore sugjerojnë larmi veprimtarish e aktivitetesh dhe sa mirë sikur të zbatoheshin të gjitha ….!
Epstein (cituar në "Kuptimi i ndryshimit"nga Fullan. M. 2010) grupoi në gjashtë lloje përfshirjen e të rriturve në edukimin e fëmijëve:
Lloji 1 - aftësitë dhe shprehitë e prindërve
Lloji 2 - komunikimi
Lloji 3 - vullnetarizmi
Lloji 4 - mësimi në shtëpi
Lloji 5 - marrja e vendimeve në shkollë
Lloji 6 - bashkëpunimi me agjencitë e bashkësisë.

*Bëji prindërit të jenë të mirëpritur.* E lehtë! E pse të mos ofrosh buzëqeshje miqësore në vend të qëndrimit autoritar nënkuptues "Unë jam mësuesi, ju jeni thjesht prind!".Të heqësh murin ndarës të dukshëm apo të padukshëm s'kërkon investim të madh, veç t'ju tregosh se ata janë të gjithë të vlefshëm, me ose pa arsimin përkatës, të kësaj apo asaj race, të njërit apo tjetrit formim kulturor. Të gjithë vlejnë! Çdonjëri prej tyre ka dhunti, talent. E pse të mos i përdorin këto talente në ndihmë të nxënësve të klasës, ku fëmija e tyre rritet e edukohet.
Ftesa mbetet e hapur: Ofroni atë që mundeni pranë shkollës, pranë klasës sonë! Sytë e fëmijëve të ndjekin gjithë gëzim tek renditin atë çfarë prindi mund të ofrojë: "Babi im është marangoz, ai na ndihmon për mjete", "Mami im është infermiere; mund të na mësojë diçka për ndihmën e shpejtë." , "Edhe mami im është valltare, ajo mund ta përgatitë grupin e valleve të klasës". Vargu i ndihmës së mundshme vazhdon dhe kufijtë ndarës zhduken. Sa të lumtur ndjehen fëmijët ditën që prindi i tyre gjendet pranë klasës për të aplikuar, atë çka ai di. Është zgjidhur pjesa kryesore e problemit, krijimi i atmosferës për të afruar të gjithë prindërit.
Fëmijët janë produkt i mjedisit në të cilin rriten. Familjet përballen shpesh me nevoja të veçanta, kur ato duan të ushtrojnë shprehitë e tyre prindërore, kur duan të jenë plotësues të nevojave, pjesë aktive në arsimimin e fëmijëve të tyre. Mungesa e të ardhurave është pengesë për familje që mund të kenë kohë mjaftueshëm, por jo burime financiare. Shumë prej tyre i shoqëron turpi se jetojnë në varfëri, ndjehen keq pasi nuk kanë mundësi t'i veshin e ushqejnë fëmijët si duhet, ose vendi ku jetojnë vështirëson studimin apo gjumin e tyre. Të tjerë prindër jetojnë me frikë pasi ata mund të ndodhen në kushte abuzimi a dhune. Është detyra e mësuesit, e shkollës të jenë "kurativë" të nxënësit në këtë këndvështrim.
E rëndësishme është veçanërisht të menaxhosh dëshirën e prindërve për të ndihmuar fëmijën në detyrat e shtëpisë e, sidomos të fëmijëve të ciklit fillor, pasi në fëmijëri hidhen themelet e jetës së njeriut. Prindërit çdo ditë janë aty për t'u interesuar se si doli sot, ç'duhet të bëjë nesër? Përse nuk po ecën si duhet me ritmin e të tjerëve? Në biseda të rastësishme dhe në takimet tematike me prindër ata interesohen për mënyrën e zgjidhjes së një ushtrimi të caktuar, apo të një interpretimi të caktuar sepse e kanë të vështirë. Prindërit do t'i kishin ndihmuar më shumë fëmijët e tyre nëse do t'ju ishte treguar se si t'i ndihmonin ata në shtëpi. Pra lind nevoja e trajnimit të tyre, të herë pas hershëm.(Fullan 2010)
**Trajnim për prindërit?!** E re kjo! Cili prej mësuesve hartoi një plan të tillë? Cili u është përgjigjur pyetjeve të prindërve që kanë jo vetëm ndryshime klasore, shoqërore, kulturore etnike, por edhe nivele shkollimi e formimi të ndryshme? Askush. Çdo mësues mjaftohet me shpjegime të rastësishme, në biseda a takime të paplanifikuara dhe shpesh nënqesh me prindin që s'di ta ndihmojë fëmijën e tij. Nxiton ta mbyllë bisedën, duke e këshilluar ta lërë fëmijën më mirë ta bëjë vetë detyrën. Është nxënësi në radhë të parë, shkolla, familja dhe vetë mësuesi që humbasin nga kjo mungesë organizimi.
**Komunikimi.**
Ajo çka gjen shprehje më tepër në traditën shqiptare të shkollës në lidhje me punën me prindërit është pikërisht kjo fushë. Sigurisht mjaft e cunguar, pa frymëmarrje! Në të gjen të ashtuquajturat "takime me prindër"; mësuesi "përcakton diagnozën" e nxënësit "në një mjedis të hapur, në një kohë të kronometruar dhe prindi në të shumtën e rasteve largohet kokulur, shpesh pa patur mundësinë të shprehë ato që mendon. Sa e padrejtë! Kjo mungesë e theksuar etike kthehet si shuplakë mbrapsht kur mësuesi, në rolin e prindit, merr të njëjtin ndëshkim që ai vetë ka aplikuar. Oborri i shkollës mbushet me prindër që vetëm qortojnë dhe fëmijë kokulur me faqet e kuqe dhe sytë e përlotur. E pamjaftueshme! Komunikim i paplotë! I njëanshëm! Komunikimi kërkon dëshirë, komunikimi kërkon kohë. Është ironike që edhe mësuesit duan që prindërit të përfshihen më shumë, por ndodh që nuk e mirëpresin ardhjen e prindërve në



ose asistent i përkohshëm i mësuesit, njihe më mirë fëmijën tënd, njihu më mirë me problemet e edukimit brenda në klasë, telefonoju prindërve të tjerë për probleme që ti konstaton, kujdesu për kopshtin e shkollës, sill lule për klasën, ndihmoji fëmijët në punët artistike, merr pjesë në projekte të ndryshme, jep mendime për planin e bordit, harto bashkë me mësuesit ftesa për bizneset në ndihmë të shkollës, etj. Lista është shumë e gjatë, por a është e tillë dashamirësia, aftësia e mësuesve, e drejtorëve dhe e shkollave për t'i menaxhuar gjithë këto.

Kërkohet plan pune, kërkohet kreativitet, investim moral e shpirtëror që në radhë të parë të largojë nga prindërit përvojat e këqija, ndjesitë e shëmtuara të shkollës së vjetër për shkak të problemeve fizike, mendore, shoqërore e emocionale që ajo ka shkaktuar në të kaluarën.

Bordet ," Lojtarët e harruar të ekipit arsimor."(Fullan.2010)

çdo kohë në shkollë, nuk i mirëpresin të gjithë prindërit njësoj, apo më keq akoma u druhen kritikave të tyre. Nga ana tjetër ka edhe prindër që afrohen me frikë në derën e shkollës, nuk kanë arsimin përkatës dhe druhen se mos shihen me përbuzje nga mësuesit. Komunikimi çalon.

Ekzistojnë shumë mënyra për ta bërë të plotë këtë komunikim; pilotim i librezës së notave, pilotim i portofolit të nxënësit (terma jo fort të përdorur për ne ), takime prindërish të kthyera në tryeza të rrumbullakëta, ku çdo herë individë që i përkasin kulturave te caktuara, të shpalosin vlerat e tyre të veçanta e të forcojë lidhjet midis prindërve e mësuesve midis vetë prindërve, midis prindërve e nxënësve. Lidhjet me telefon, komunikimi elektronik mund të zëvendësojnë shumë ëmbël dërgimin e letrave urgjente në familje për "prapësitë" e fëmijës, duke i alternuar ankesat e herëpashershme edhe me fjalë lavdëruese e përkrahëse, ndoshta jo vetëm për rezultatet akademike edhe për pjesëmarrje aktive në lojërat me dorë, për ndihmën që fëmija jep ndaj shokëve, për sjellje shumë të mirë, për.......

**Punë vullnetare!** A ekziston vërtet? Sa njihet e përdoret ajo në Shqipëri? Nëse pyet një mësues a prind, gjëja e parë që i shkon në mend është dhënia e kontributit modest financiar, ose e ndonjë ndihme në mjete mësimore a pajisje për klasën. Por edhe kjo është e pamjaftueshme! Studiuesit këshillojnë:

Nxitni patosin në shkollë! Promovoni prindërit si instruktorë në shtëpi! Identifikojini, promovojini si vullnetarë në shkollë! (Fullan.2010) Prindi si instruktor në shtëpi funksionon edhe pa shumë nxitje kur fëmija është ende i vogël. Prindërit nxitojnë në ndihmë të kryerjes së detyrave të shtëpisë. "Mami sot duhet të krijojmë 2 problema", "Mami, duhet të vizatojmë sistemin tonë diellor", "Babi, a më ndihmon të përgatitim një album me kafshë, të shkruajmë një esse, të përgatitim një maket të hidrocentralit, të nxjerrim materiale nga interneti...." dhe lista e gjatë vazhdon. Mos vallë fëmijët mbingarkohen? Mundet! Apo është e domosdoshme kjo mbingarkesë në mënyrë që të nxisë nevojën e fëmijës për të thithur edhe edukimin prindëror. Ndodh të jetë edhe e ndërsjellët. Prindërit mund të sensibilizohen nëpërmjet detyrave të fëmijëve: Mendoni së bashku: "Si të shpëtojmë Tokën nga ndotja? Po ujin? A mund ta frenojmë ne ngrohjen globale?...

Promovojini prindërit si vullnetarë! (Fullan. 2010)

Kemi kapacitete në këtë fushë? Plot! Shumë të pashfrytëzuara! Duhen përdorur teknika të reja. Ka shumë gjëra që mund t'i bëjnë prindërit. Disa mund të bëhen në shtëpi, të tjerat në klasë, në shkollë. Prindërit të zgjedhin ku duan të aktivizohen dhe sa kohë e energji mund të japin. Listohen shumë të tilla, nëse shkolla dëshiron vërtetë t'i organizojë: Bëhu prind pjesëmarrës,

- Cili është roli i tyre në lojën e edukimit?

S'mund të thuhet se s'janë të pranishëm në listat e drejtorisë të shkollës. Diku gjenden aty në sirtar. A funksionojnë? Sapo shkolla hap dyert e saj thërret prindërit dhe i bën ata pjesë të procesit të marrjes së vendimeve. Edhe pse jo të gjithë kanë kohë, apo prirje për t'u kandiduar në bordin e shkollës, gatishmëria nuk mungon. Por sa të përfshirë e ndjejnë veten ata? Ndodh që edhe të ftohen në shkollë sa herë që nevojitet nënshkrimi i tyre; në miratimin e planit të shkollës, në përdorimin e buxhetit, por kjo është shumë pak. Gjërat duhet të ndryshojnë sa më parë. Përgatitja e anëtarëve të bordit është e dëshirueshme, e domosdoshëm. Prindërit e informuar mund të bëjnë mrekullira. Me vlerë do të ishte që ndryshimi të vinte nga brenda shkollës, të rritet ndjeshmëria e saj ndaj pikëpamjeve të prindërve. Le të punojmë që idetë e tyre të gjejnë pasqyrim në planet e shkollës, që potenciali i vërtetë i prindërve në vendimmarrje të realizohet një ditë.

Marrëdhënia me komunitetin. Familja s'është një ishull, asnjë prej familjeve nuk funksionon e izoluar nga shoqëria, por komuniteti është i plogësht. Prej kujt pritet ftesa? Shkolla është e të gjithëve dhe reformimi i saj, një fushë për kontributin e shumëkujt.

U urrye ajo çka ishte ngritur në një front të përbashkët, të gënjeshtërt dhe sot e kësaj dite vepron inercia e një fryme që përbuz, apo nënvlerëson çdo bashkëpunim në komunitet. Nuk njihet asnjë lloj organizimi bashkësocial që mund të jetë fitimprurës nga ana morale. Ndihet paaftësi për të krijuar aktivitete improvizuese me qëllim edukimi. Mungon pikë së pari vullneti për të bërë diçka e më pas boshllëku intelektual. Është e vështirë të pranohen modelet më të përparuara për arsimimin, sepse është e vështirë të pranohet se ndihma që japim dhe na jepet është e sinqertë dhe e padëmshme.

Ajo në të cilën duhet të përqendrohet puna është luftimi i një mentaliteti të tillë antisocial dhe përpunimi i planeve, qoftë afatshkurtra për t'i ardhur në ndihmë komunitetit, sepse nga këto plane lindin ato afatgjata dhe me rezultat. Kërkohet menaxhim, menaxhim i ndryshimit.

***Referencat***


**Batey S. Carol (2003) Prindërit janë shpëtimtarët e jetës Tiranë CRS**

**Fullan M. (2010) Kuptimi i Ri i Ndryshimit në Arsim Tiranë: CDE**

**Menaxhimi efektiv i shkollës (2002) Tiranë Dita 2000**

# Mësuesi zemra e tolerancës



***E rëndësishme është të bëjmë të mundur një vlerësim të përgjithshëm të tolerancës, që në ditët e para të fillimit të vitit shkollor. Por nga ana tjetër mendoi, se mësuesi duhet të jenë të gatshëm për të kapur në kohën e duhur manifestimin e simptomave në klasën e tij, që drejtojë gjithë aktivitetin e nxënësve të vet.***

Ashtu si zemra përgatit energjitë fondamentale të jetës për trupin njerëzor, mësuesi përgatit energjitë për mësimin e vlerave dhe të marrëdhënieve midis nxënësve. Është mësuesi ai që i jep jetë përvojës, duke e bërë atë të mundur për t'u mësuar nga nxënësit. Por një rol të dorës së parë luan, vlera e mësuesit, klima që ai krijon dhe mjeshtëria në dhënien e njohurive, që përcaktojnë rezultatet që do arrihen në klasë. Mësuesit janë, qenie njerëzore, subjekte të së njëjtës influencë dhe proceseve sociale, ashtu si pjesëtarët e tjerë të komunitetit. Një mësues intolerant e ka të vështirë të edukojë tolerancë. E kuptuar ndryshe, është mirë që ai të përballet me këto probleme në stadin e përgatitjes përpara se të marrë përgjegjësinë e daljes para klasës.

Intoleranca është shenja që bart mundësinë e një jete të rrezikuar prej sëmundjes shoqërore-violencës. Ajo është patologji që kërkon mobilizimin e forcave të mundshme për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien sociale. Intoleranca është e thjesht për t'u parë, veçanërisht kur vepron me violencë ndaj të drejtave të njeriut.

Toleranca përcakton cilat kushte janë të patolerueshme dhe cilat forma të sjelljes janë për t'u ndaluar. Të mësuarit e tolerancës mbështetet mbi një klasë tolerante dhe paqësore dhe të tilla klasa janë krijuar prej tolerancës dhe paqësisë së mësuesve.

Shkolla cilësohet e mirë nga komuniteti, kur mësuesit punojnë dhe kanë rezultate. Sa më shumë nxënës me rezultate të mirë të ketë shkolla, në të cilën punojnë mësuesit, aq më shumë rriten dhe vlerat e shkollës dhe të stafit të mësuesve.

Përgatitja profesionale dhe aftësia personale e mësuesit përcaktohet se sa është i aftë ai, të zbërthejë programin mësimor, të përcaktojë objektivat për të përmbushur standardet shtetërore për kurorëzimin me sukses të përvetësimit të programit mësimor nga ana e nxënësve.

Një rol të rëndësishëm në të qenit tolerant te mësuesi luan trajnimi i vazhdueshëm, që ai të krijojë vizion për rolin dhe përgjegjësin e profesionit në procesin e të mësuarit.

Nga ana tjetër, nuk duhet nënvleftësuar roli i familjes dhe shtëpisë në krijimin e tolerancës, ku nxënësi kalon pjesën më të madhe të kohës.

Prindërit dhe mësuesi kujdestar kanë për detyrë të përgatitin dhe të fusin të rinjtë në rrugë, të cilat do t'u mundësonin zhvillimin e aftësive për tolerancën dhe paqen.

Toleranca është kualiteti minimal esencial i lidhjeve sociale që veçon violencën dhe detyrimin me forcë. Pa tolerancë paqja është e pamundur. Nxënësit e përfshirë direkt me shokët e tyre duhet të reflektojnë mbi pasojat aktuale dhe të mundshme e të vlerësojnë efektet që këto pasoja mund të kenë në klasë. Edukimi i vlerave të tolerancës kërkon shumë vemëndje nga stafi drejtues, që aplikimi të përfshijë pjesë të ndryshme të organizmit shkollor, ku të përfshihen një numër mësuesish të disiplinave të ndryshme. E thënë ndryshe, kjo nënkupton që në planifikim duhet bërë koordinimi dhe komunikimi sa më efektiv, ku vlerat e programit të edukimit të jenë sa më shumë të kuptueshme për shkollën dhe nxënësit.

Mësuesit mund të paraqesin për diskutim "Karakteristikat e klasës tolerante".

Disa nga çështjet e tolerancës dhe pyetjet që mund t'u drejtojmë nxënësve, përgjigjet e të cilave na çojnë në zbulimin e tyre janë:

**Gjuha:** - A thërrasin nxënësit emrat e njëri-tjetrit apo përdorin epitete.

**Stereotipi:** - A bëjnë nxënësit përgjithësime me terma negative rreth grupeve etnike, të gjymtuarve apo të moshuarve.

**Nga Bashkim SALIASI**

**Të ngacmuarit:** - A kërkojnë nxënësit të vënë në pozitë të vështirë të tjerët duke u tërhequr vëmendjen në disa karakteristika personale, gabime apo kushte të jetesës, familjeve dhe shokëve të tyre.

**Paragjykimi:** - Gjykojnë nxënësit se disa prej tyre janë më pak të vlefshëm për shkak të origjinës së tyre etnike, raciale apo tipareve personale?

**Kalimi i fajit te të tjerët:** - A priren fëmijët për të fajësuar për prapësitë, sjelljet e këqija, konfliktet, humbjet në sporte apo gara të tjera, një apo disa shokë të veçantë?

**Diskriminimi:** - A i shmangin nxënësit disa prej shokëve të tyre, duke mos i zgjedhur si partnerë, apo lojtarë të skuadrës sipas rregullave?

**Izolimi** - A provojnë nxënësit periudha në të cilat një apo disa nxënës të tjerë nuk thirren, apo nuk përfshihen në aktivitetet e tyre?

**Shqetësimet** - A kërkojnë disa nxënës të sjellin shqetësime tek të tjerët duke i nxjerr me forcë nga rreshti, duke u lënë shënime anonime apo karikatura mbi bankat ose librat e tyre etj?

**Shëmtimi:** - A dëmtojnë nxënësit pronën, apo punën shkollore të shokëve të tyre?

**Imponimi:** - A vuajnë nxënësit prej kërcënimeve me paramendim nga nxënësit e tjerë, më të rritur apo më të fuqishëm?

E rëndësishme është të bëjmë të mundur një vlerësim të përgjithshëm të tolerancës, që në ditët e para të fillimit të vitit shkollor. Por nga ana tjetër mendoi, se mësuesi duhet të jenë të gatshëm për të kapur në kohën e duhur manifestimin e simptomave në klasën e tij, që drejtojë gjithë aktivitetin e nxënësve të vet.

Në shumë literatura shkruhet, që nuk është e rekomandueshme të mbajturit qëndrim ndaj fajtorit në prani të klasës, as të treguarit dhembshuri për viktimën. Reagimi duhet të fillojë me të mësuarit e atyre çështjeve që lidhen me format e pranishme të intolerancës, me qëllim që nxënësit të jenë të ndërgjegjshëm për to në mënyrë jo kërcënuese. Përqendrimi, së pari duhet të jetë mbi problemin, më pas mbi marrëdhëniet dhe jo mbi personat e përfshirë, derisa ekziston një mungesë e të kuptuarit e cila do t'i aftësonte nxënësit të marrin përgjegjësi për veprimet e tyre.

Toleranca nuk është një fund, por një fillim, hapi i parë në procesin e gjatë e të thellë të zhvillimit të një kulture paqeje.

Mësuesit për të njohur sjelljen e klasës mund të përdorin shfaqjet e përshkruara më lartë në formën e një provimi duke i përshtatur ato me qëndrimin dhe sjelljen e nxënësve të tyre. Mënyrat e organizimit të testimit janë nga më të ndryshmet, por njëra nga to është dhe ngritja e një grupi prej dy tre vetash, për të nxitur dhe forcuar aftësitë e mësuesve për të mësuar për tolerancën dhe rreth saj.

Diskutimet mund të zhvillohen edhe gjatë zhvillimit të orës edukative, duke u dhënë mundësi nxënësve që të reflektojnë për pasojat e veprimeve të tyre, si hap themelor në marrjen e përgjegjësive dhe si bazë për motivime morale në vendimmarrje.

Mendoj se mësuesi është zemra e tolerancës, kur gëzon respektin e nxënësve dhe të kolegëve dhe zotëron aftësi për të vepruar në situata të caktuara me autoritetin e tij. Realiteti është tërësisht i përfshirë në marrëdhënie mundësie dhe përgjegjësie. Ky koncept përbënë parimin themelor të demokracisë. Të gjithë qytetarët kanë mundësi të veprojnë dhe të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre para shoqërisë.



# Çfarë presin prindërit nga ne mësuesit?

**Mimoza BERISHA (THAÇI)**
**Specialiste vlerësimi në AVA**

***Prindërit, gjithnjë duan për fëmijët e tyre një mësues të mirë. Të gjithë jemi dakord se prindi me mësues të mirë quam atë mësues që është i drejtë, që e bën mësimin interesant dhe është një profesionist në mësimdhënie. Zakonisht, ky është tipi i mësuesit që edhe nxënësit duan dhe në këtë rast prindërit janë të kënaqur kur fëmijët e tyre janë të kënaqur me këtë mësues. Ashtu si nxënësit edhe mësuesit kanë personalitete të ndryshëm, stile pune të ndryshëm dhe forca të ndryshme për të vazhduar këtë profesion jo shumë të lehtë. Prindërit duan që fëmijët e tyre të kenë mësues që i ndihmojnë fëmijët e tyre të rriten, të mësojnë, të zhvillohen dhe të kënaqen në procesin e nxënies së dijeve.***

Çdo mësues duhet të dijë disa nga gjërat kryesore që një prind pret nga ai/ajo si mësues:

1. T'i komunikojë prindit probleme që fëmija e tij mund të ketë me sjelljen dhe nivelin e arritjeve në lëndë të ndryshme.

2. T'u tregojë fëmijëve të tyre jetë, gjallëri, gëzim për të mësuar diçka të re. Nxënësit duhet ta dinë se edhe mësuesit janë qenie njerëzore po ashtu si ata.

3. T'u ofrojnë ndihmë plus fëmijëve që kanë nevojë.

4. T'i bëjnë mësimet sa më praktike dhe të vlefshme në mënyrë të tillë që kur nxënësi të shkojë në shtëpi t'i bëjë pyetjen vetes: "Kjo që mësova sot, kur do më duhet për ta zbatuar? A do më hyjë në punë ky lloj informacioni që morëm sot gjatë mësimit?"

5. Të bëj nxënësit të ndërgjegjshëm për përgjegjshmërinë që ata duhet të kenë në procesin e të mësuarit si dhe t'u bëj të mundur atyre që atë që ata mësojnë, të kenë mundësi ta vënë në zbatim.

6. Të zotërojë një kontroll të fortë dhe të plotë të klasës, por njëkohësisht ky kontroll të jetë dashamirës dhe pozitiv.

7. Të njohë veçantitë e personaliteteve të ndryshme të nxënësve të tij/saj, aftësitë e tyre të ndryshme të të mësuarit, stilet e tyre të ndryshme të punës gjatë procesit të të mësuarit.

8. Të trajtojë të gjithë nxënësit me drejtësi dhe në vazhdimësi.



Të mos përdorë sarkazmin dhe ironinë me nxënësit, por të jetë i drejtpërdrejtë në mendimin dhe gjykimin e tij.

9. Të përdorë metoda dhe strategji të ndryshme gjatë mësimdhënies. Të mos jetë në rolin e lektorit, por të prezantojë mësimin me larmi formash, si për shembull: me power- point, ose ndonjëherë me anë të një filmi ku nxënësi merr mesazhe të rëndësishme prej tij, me një bisedë të hapur rreth një teme të caktuar, etj.
Motivo, motivo, motivo! Nuk ka rëndësi se ç'përgjigje do të japin nxënësit. Të jeni të sigurt që përgjigja e tyre nuk do të jetë e mërzitshme.

10. Kënaqu sa të mundesh me nxënësit e tu dhe shprehe gëzimin tënd, mos e mbaj brenda vetes; të jesh i sigurt që kjo ka efekt të jashtëzakonshëm në pjesëmarrjen aktive të tyre dhe në efikasitetin e një ore mësimi.



***Kurrë mos harroni ndikimin që një mësues ka në jetën e një nxënësi. Edhe sikur rrallë t'i jepni mësim, prezenca juaj mund të jetë e pashlyeshme në mendjen e një nxënësi. Gjatë një dite, nxënësit më shumë kalojnë kohë me mësuesit sesa me prindërit e tyre. Detyrat që mësuesi i jep një nxënësi përcaktojnë edhe kalendarin e veprimtarive të tij të ditës duke qenë mësimet parësore dhe pastaj të tjerat.***
***Se si një mësues është sjellë gjatë ditës me nxënësin e tij përcakton edhe humarin e pjesës tjetër të ditës që nxënësi e vijon me familjen e tij duke reflektuar pozitivitetin ose të kundërtën që mund ta ketë marrë në shkollë nga mësuesit e tij.***
***Ngandonjëherë, personaliteti i mësuesit, forca e tij e karaktrit, përkushtimi i tij në punë janë vendimtarë në atë se sa mirë nxënësi do mësojë dhe arrijë objektivat e lëndës, nëse te ai nxënës do zotërojë ndjenja e tërheqjes, heshtjes, apo suksesit.***



*Nëpër shkollat shqipe, në diasporë...*

# Dashuria për gjuhën amtare tek fëmijët tanë

**Nga Sokol DEMAKU**

Në ditët bashkëkohore, ne jemi dëshmitarë të asaj se tek shumë fëmijë, të rinj dhe të reja shqiptarë në vendet perëndimore, gjuha amtare ka kaluar në gjuhë të dorës së dytë. Këtë nuk është fare vështirë njeriu ta kuptojë, apo edhe ta përjetoj. Këtë mund ta kuptojmë më së miri nga vet angazhimi i ynë dhe i të rinjve në diasporë, angazhimi i familjes në këtë drejtim si dhe enteve dhe institucioneve mësimore në diasporë.

Sa duket këtu qëndron edhe problemi se sa këto janë të angazhuara në këtë drejtim.

Çdo ditë e më shumë fëmijët tanë i janë të nënshtruar asimilimit gjuhësor, sepse ata thuajse nuk përdorin gjuhën amtare, por gjuhën e vendit ku jetojnë. Kjo, me të vërtetë është shqetësuese për ne, kur shohim se një pjesë e fëmijëve tanë gjuhën e nënës e konsiderojnë si gjuhë të dorës së dytë, por kjo ka edhe arsyet e veta. Shkaqet dhe arsyet janë më të shumta e do përmendim vetëm disa që janë aktuale dhe kanë ndikim shumë negativ dhe të madh në këtë çështje.

-Organizimi i dobët i mësimit plotësues për fëmijët tanë në diasporë.

-Angazhimi i njerëzve me profesion jo adekuat që merren me organizimin e kësaj çështje madhore për fëmijët tanë.

-Mësimi plotësues i gjuhës amtare është fakultativ që ka efekt negativ tek fëmijët.

-Në shumë vende perëndimore, mësimi i shqipes bëhet në mënyrë private nga prindërit,

-Angazhimi jo i mjaftueshëm i prindërve në këtë drejtim,

- Angazhimi i mësuesve te pakualifikuara për punë me gjuhën amtare.

Këto janë disa nga dukurit më të shpeshta të cilat kanë ndikim negativ vendimtar,por ka edhe shumë e shumë probleme tjera në zhvillimin dhe kultivimin e gjuhës së nënës tek fëmijët tanë.

Ky fenomen që është mjaft aktual është duke u përhapur ditë e më shumë jo vetëm tek fëmijët tanë që kanë lindur në diasporë, por edhe tek ata të cilët kanë lindur në vendlindje e më vonë kanë migruar.

Ne si prindër duhet të kuptojmë se kjo dukuri është shumë e dhimbshme dhe është mjaftë shqetësuese.

Duhet të kuptojmë se rolin kryesor në edukimin dhe arsimimin e tyre e luan familja, shkolla dhe rrethi ku fëmija jeton dhe rritet.

Secili nga këta faktorë ka apo mban një pjesë të përgjegjësisë në arsimimin dhe edukimin e fëmijës. Por pyetja është se sa janë të angazhuar në këtë drejtim këta tre faktor kyç në këtë proces dhe sa është rezultati i tyre në këtë drejtim.

Ne duhet të kuptojmë së fëmijët në diasporë takojnë një shoqëri tjetër, takojnë një kulturë tjetër, një traditë diametralisht tjetër me traditën tonë. E terë kjo ka efekt ne jetën e fëmijës dhe të riut.

Në bazë të disa studimeve që janë bërë në shumë vende perëndimore del se nëse fëmija mëson paralel dy gjuhët, ai do jetë më i suksesshëm në jetë e këtë gjë shumë prindër tanë e injorojnë apo e marrin si jo serioze.

Në shumë vende evropiane çështjes së mësimit të gjuhës amtare të emigrantëve i kushtohet një rëndësi shumë e madhe e në këtë drejtim prijnë vendet skandinave të cilat derdhin shuma të mëdha mjetesh financiare në këtë drejtim. Ne na takon të gjejmë mësues të zotë që t'i angazhojmë në mësimin e gjuhës amtare.

Studimet tregojnë se është më lehtë ta mësosh një gjuhë të dytë, kur njëkohësisht ke një bazë të shëndoshë në gjuhën tënde, në gjuhën amtare. Ato dy gjuhë, nuk kanë nevojë të konkurrojnë njëra me tjetrën, por, ato të funksionojnë si ndihmesë e njëra- tjetrës. Nëse fëmija ka mësuar një nocion në gjuhën amtare, atëherë është më lehtë ta mëson fjalën me një nocion të ngjashëm në gjuhën e dytë dhe anasjelltas. Nuk janë të rralla rastet, kur fëmijët gjatë disa periudhave preferojnë përdorimin e gjuhës së vendit ku jetojnë, edhe pse prindërit mundohen të jenë konsekuentë dhe flasin gjuhën amtare me ta. Nëse prindërit dëshirojnë që fëmija të bëhet dygjuhësor, atëherë është me rëndësi që ata të vazhdojnë ta përdorin gjuhën amtare me fëmijën në familje. Është mirë, nëse moshatarët dhe të rritur të tjerë, përdorin gjuhën amtare me fëmijën, ashtu që gjuha të vihet në funksion edhe jashtë familjes. Kontaktet dhe komunikimi me fëmijën janë të rëndësishme, pavarësisht se cila gjuhë përdoret. Më me rëndësi është të dëgjosh se ç´thotë fëmija, sa sa mënyra se si e thotë. Është, po ashtu, më lehtë t´i edukosh fëmijët në një gjuhë në të cilën i shprehë ndjenjat



më lehtë, pra në gjuhën amtare. Shumë të rritur e kanë më lehtë të tregojnë përralla dhe tregime nga fëmijëria, të këndojë këngë, të krijojë rimë, së bashku me fëmijën, në atë gjuhë që ata vetë e kanë folur si fëmijë pra, në gjuhën e nënës. Këto aktivitete janë shumë domethënëse, jo vetëm për lidhjet me fëmijën, por edhe për zhvillimin e gjuhës tek fëmija në përgjithësi dhe se këto do kenë efekte pozitive në të folurit dhe gjuhën e fëmijës..

Përvoja tregon se fëmijët që kanë ndjekur mësimin plotësues shqip, e flasin rrjedhshëm shqipen, e njohin bukur historinë dhe kulturën shqiptare, si dhe janë të suksesshëm edhe në lëndët tjera mësimore në gjuhën e vendit ku jetojnë.

Pra, ne shqiptarët në mërgim, lëmë gjurmë jete në vende të huaja.,Nëse jemi treguar edukatorë të mirë, atdhetarë të mirë, edhe gjurmët do të i lëmë të mira, ana tjetër çon drejt asimilimit gjuhësor, rrënimit kulturorë e gjuhësor dhe lënë gjurmë të këqija në vendin e huaj, por pasojat dhe çmimet e haraçit do të paguajë fëmija dhe prindi.

Çdo shqiptar, e ka obligim kombëtar, moral e etik, që fëmijën e vet ta edukojë dhe ta ruajë atë nga harresa e gjuhës sonë.

# Prof. Bedri Dedja - Misionar i arsimit shqiptar



**Yllka BEÇI**
**Kryetare e Shoqatës së Arsimtarëve të Shqipërisë**

***Në leksionet e tij nuk na mësonte vetëm psikologji, por na jepte edhe mendësi të reja në marrëdhëniet pedagog-student e anasjelltas. Na trajtonte si shokë e shoqe dhe na merrte kurdoherë mendimin tonë të sinqertë. Shkurt, na trajtonte si subjekt dhe objekt të edukatës.***

Siç dihet, populli ynë ka qenë dhe është mjaft arsimdashës. Rilindësit tanë kanë bërë shumë sakrifica për ta ruajtur këtë virtyt ndër shekuj. Nën shembullin e tyre, ka mësuar, punuar dhe shkruar Akademiku Bedri Dedja, ish-profesori im i psikologjisë në Universitetin e Tiranës. Ai e zbatoi më së miri mesazhin e Sami Frashërit, se: "Mendja e një kombi është arsimi, zemra e tij, morali i përgjithshëm". Ishte një ndër përfaqësuesit e denjë të intelektualit të zgjuar, i palodhur, puna dhe mençuria e të cilit hapi horizonte të reja për studimin, mënyrën e të jetuarit në familje, si dhe dashurinë, respektin e mirënjohjen ndaj popullit, prindërve, të cilat na arsimuan duke sakrifikuar për ne e duke na ngulitur në mendje e në zemër, se jeta është shkollë dhe të mësuarit është i përjetshëm.

Te Prof. Bedri Dedja gjeti mishërim të plotë edhe thënia e shkrimtarit rus, A.Çehov, se: "Te njeriu, gjithçka duhet të jetë e mirë: pamja, veshja, por më kryesorja-shpirti". Ai ishte elegant, njeri i thjeshtë, i sjellshëm me cilindo, i respektueshëm me të gjithë. Ne, studentët, mezi prisnim ta zhvillonim me të leksionin e radhës, sepse ai nuk ishte thjesht një pedagog i psikologjisë, por një misionar i arsimit shqiptar dhe një demokrat i vërtetë. Në leksionet e tij nuk na mësonte vetëm psikologji, por na jepte edhe mendësi të reja për marrëdhënjet pedagog-student e anasjelltas. Na trajtonte si shokë e shoqe dhe na merrte kurdoherë mendimin tonë të sinqertë. Shkurt, na trajtonte si subjekt dhe objekt të edukatës.



*Prof. Bedri Dedja (lart, i treti, nga e djathta) dhe Pandora (lart, e dyta, nga e majta), ndërmjet anëtarëve dhe veprimtarëve të Shoqatës së Arsimtarëve të Shqipërisë, ku është kryetare Y.Beçi (në mes, lart)-Tiranë, 7 Mars 2003*

Profesor Bedri Dedja, si dhe pedagogë të tjerë, na edukuan me shembullin e tyre vetjak, që të mësonim mirë, të punonim fort, duke e vlerësuar meritën e shokut ose shoqes, pa shfaqur smirë për arritjet e tyre dhe duke krijuar kështu mendësi të reja për individin e mençur, për të formuar mendimin dhe marrëdhënie shoqërore të tilla, ku të respektohet e nderohet personaliteti i gjithsecilit.

Ai e kuptonte mirë dhe e ndjente shpirtërisht që ne kishim vështirësi në mbajtjen e leksioneve me shkrim dore, sepse ne shumicën e rasteve na mungonin tekstet. Por në leksione na fliste ngadalë dhe gjente hapësira të na fliste edhe për nevojën e të mësuarit sistematik, na rekomandonte literaturë e studimin në bibliotekat e kryeqytetit, si dhe përdorimin e një teksti në mënyrë kolektive etj.



Prof. Bedri Dedja, duke qenë psikolog i aftë, i njihte mirë veçoritë psikologjike të moshës. Prandaj shpesh na fliste me takt për marrëdhëniet ndërmjet të rinjve, djemve e vajzave. Kjo sepse i ndjente dhe i përjetonte dëshirat dhe pasionet e studentëve të tij. Por, njëkohësisht, i goditi ashpër disa koncepte të dëmshme në marrëdhëniet shoqërore, p.sh. moslejimin e lidhjeve martesore ndërmjet të rinjve me fe të ndryshme etj.

Ai, gjithashtu, hodhi hapat e parë përmes forcës së fjalës, eksperimentit dhe librave të shkruara për prindër e fëmijë, me synimin për një edukim të lirë të çdo fëmije dhe krijimin e personalitetit të gjithsecilit, mbi bazën e meritës. Respektonte aftësitë mendore e praktike të fëmijëve e studentëve dhe përpjekjet për t'i futur ata në jetën e përditshme, duke pasur në themel punën këmbëngulëse për dije, dashurinë për jetën, respektin për njëri-tjetrin dhe duke mos harruar detyrën kryesore, dashurinë për familjen e Atdheun tonë të shtrenjtë.

Akademiku Dedja e kishte të qartë, si dhe ne arsimtarët sot, se fjala dhe këshilla nuk kanë ndikim njëlloj te secili nxënës, student ose mësues. Prandaj përpiqej që, me shembullin e tij vetjak, të ndikonte sadopak te studentët e tij dhe te gjithë brezi i ri i vendit tonë. Te Profesori ynë i psikologjisë ne vërenim korrektësinë në punë, lidhjet korrekte me kolegët e vartësit, vlerësim të punës dhe djersës sipas meritës. Ai nuk fyente njeri, por dhe vërejtjet që mund të kishte në adresën tënde, t'i bënte me takt e dashamirësi, duke shkëmbyer mendime, p.sh. edhe me hartuesin e një shkrimi ose punimi. Bisedonte shtruar, si ndërmjet të barabartëve, pavarësisht nga mosha e re, arsimimi ose përvoja në punë.

Profesor Bediu do të mbetet gjatë shembull frymëzimi për ata, që e kanë njohur ose që kanë punuar me të, që kanë pasur lidhje me familjen e tij shembullore, e cila rriti dhe edukoi dy fëmijë, Edlirën e Taulantin, që u bënë dikushi dhe me personalitetin e vet, në shoqërinë shqiptare. Por dëshiroj të shënoj këtu se ai pati bashkëshorte Pandora Dedjen (Papuçiu), një nga nxënëset më të mira të shkollës së mesme pedagogjike të Tiranës dhe, më pas, studiuese e zellshme në fushën e arsimit. Ajo u bë bashkëshorte shumë e mirë për të, por dhe një bashkëpunëtore e pandarë në veprimtarinë dhe krijimtarinë e gjithanshme: arsimore, letrare e shkencore të tij.

Shoqata e Arsimtarëve të Shqipërisë, që nga themelimi i saj, më 3 qershor 1996, pati nderin që në anëtarësinë e saj të kishte çiftin e palodhur e dashamirës Dedja. Ata kanë marrë pjesë në veprimtari të ndryshme dhe kanë ndihmuar me referatet e diskutimet e tyre, gjithnjë profesionale: arsimore, pedagogjike, psikologjike e metodike. Prandaj anëtarët dhe veprimtarët tanë do t'i kujtojnë ata kurdoherë me mall, nderim e respekt të thellë. Në festa të tilla, si për Shpalljen e Pavarësisë Kombëtare ose 7 Marsin, Ditën e Arsimit Kombëtar Shqiptar, me kënaqësi të veçantë, kemi bërë edhe fotografi bashkë me Prof. B. Dedjen e bashkëshorten e tij, të cilat janë një kujtim i bukur dhe i paharruar për ne.

Akademikun e shquar Bedri Dedja, ne do ta ruajnë të pashlyer në kujtesë dhe do ta kemi gjatë tërë jetës, shembull për t'u ndjekur.

# A ka rregulla për mësuesit në shkolla ?

Arben POROÇANI, as. pedagog

Sapo ka kaluar 1 muaj nga fillimi i vitit shkollor dhe mësuesit janë njohur me të gjitha udhëzimet e fundit të MASH lidhur me procesin mësimor. Në fakt, kur bisedon me prindër apo nxënës, ata tregojnë që sapo kane nisur edhe kurset me mësuesit e tyre. Kjo mbetet shqetësuese, përderisa ato nuk janë të organizuara apo të licencuara. Por, qëllimi i këtij shkrimi nuk lidhet me këtë fakt, por, me diçka më shumë se kaq. Dikujt mund t'i duket e habitshme pyetja e shtruar më lart. Kur takohesh e bisedon me prindër të ndryshëm, për ta është shumë shqetësuese ( më vjen keq ta shpreh ) paraqitja e disa mësuesve në shkolla, sjellja e tyre me nxënësit, apo mënyra e vlerësimit që ndjekin në lëndë të caktuara. Nisur nga ky fakt, qëllimi ynë nuk është nxjerrja në pah e këtyre veprimeve apo zënia në gojë e emrave të veçantë të mësuesve. Mendoj se duke folur për rregulla të mësuesve në shkollë dhe respektim rigoroz të tyre, kjo do sjellë një atmosferë të re në shkollat tona.




Kështu, edhe nxënësit do ndjehen më mirë e më të kënaqur, edhe prindërit nuk do të përflasin më për mësues të veçantë. Kur flitet për rregulla të mësuesve, duhet të kemi parasysh se nuk janë " jashtë mode " apo të kaluara, por janë më se të domosdoshme në kushtet tona. Nëse i referohemi historisë së arsimit në shkollat simotra evropiane, shohim se është folur për rregullat e mësuesit që në vitet 1870, ku ndër të tjera, aty përmendet :

- *Mësuesi duhet të përdorë ujin gjatë kohës kur është në shkollë për të pastruar veten e tabelën;*
- *Mësuesi duhet të tregohet i kujdesshëm e i vëmendshëm gjatë plotësimit të dokumenteve shkollore ;*
- *Mësuesi duhet ta mbajë lapsin sa më kujdesshëm për t'ia treguar edhe nxënësve një gjë të tillë ;*
- *Mësuesi nuk duhet të pijë duhan në shkollë ;*
- *Mësuesi duhet të pasurojë laboratorin e tij çdo muaj, përndryshe mund edhe të gjobitet nga paga e tij.*

Ndërsa, pas viteve 1912 këto rregulla ndryshojnë disi, duke patur parasysh edhe zbulimet e bëra apo mjetet e reja që u shpikën në atë kohë.

Në disa prej tyre thuhet :

- *Mësuesi duhet të jetë në shkolla nga ora 7.30 deri më 15.30*
- *Mësuesi nuk duhet të vishet me rroba që kanë ngjyra shumë të ndezura*
- *Mësuesit nuk duhet të lyejnë flokun e tyre me bojëra*
- *Mësueset femra nuk duhet të veshin rroba të shkurtra*
- *Mësuesit duhet të marrin masa për të mbajtur klasën pastër gjatë mësimit*
- *Mësuesit nuk duhet të lëvizin me makinat e nxënësve të tyre*
- *Mësuesit nuk duhet të dalin nga shkolla gjatë kohës së tyre të lirë.*
- *Mësuesi duhet të vijë në klasë në kohën e duhur*
- *Mësuesi nuk duhet të hajë në klasë*
- *Mësuesi duhet të flasë qetësisht me nxënësit dhe me gjuhë të kuptueshme.*

Tani çdokush që i lexon këto rreshta, mund edhe të kundërshtojë duke thënë se ato ekzistojnë. Ndoshta, ekzistojnë, por, sa zbatohen ato. Së fundi, dua të shtoj se ato rregulla janë formuluar 1 shekull më parë, disa prej të cilave kanë vlerë edhe sot. Në ditët tona, përveç këtyre, patjetër, që duhen shtuar edhe të tjera sa më të përshtatshme, bashkëkohore e në përputhje me misionin që ka shkolla jonë sot e që duhet të përfshijnë të gjitha aspektet e punës së mësuesit në shkolla ( veshjet, mjetet e përdorura, gjuha, sjelljet, kurset, puna shkencore individuale apo kolektive etj. )…

Është për t'u përgëzuar nisma e mjaft drejtorive të shkollave për veshjen e nxënësve me uniforma. Po mësuesit tanë a kanë një të tillë ? Pse jo ? E pra, a nuk do të ishte më e hijshme dhe më elementarja veshja e një uniforme të thjeshtë dhe e përshtatshme në orarin e punës ? Ajo që të bie në sy te disa mësues është veshja e përparëses së bardhë, që jo vetëm reflekton seriozitet e importon respekt te nxënësit, por edhe mban pastër çdo mësues.

Gjithashtu, është për t'u admiruar veshja serioze e disa mësuesve të tjerë burra, të kompletuar me kostum e kollare ( përveç drejtorit të shkollës ). A nuk është kjo një paraqitje dinjitoze në shkollë ? Pse të mos bëhet rregull pune kjo paraqitje ? Etika profesionale bashkë me atë të veshjes e sjelljes, përbëjnë themelin e suksesit të punës te çdo individ.

Sot, në kushtet e globalizmit, ku edhe arsimi ynë po reformohet drejt atij europian, në shkollat tona duhet të mbizotërojë puna, përkushtimi, interesimi maksimal, vullneti për të përsosur gjithnjë e më shumë kurrikulat e lëndëve shkollore, për të ndryshuar metodologjinë e dhënies së mësimit duke përdorur mjetet bashkëkohore, vizuale, apo duke organizuar grupe pune bashkë me nxënësit për kërkimin shkencor. Prandaj, nuk duhet të flasim më për rregulla elementare, por për përsosje të tyre në përputhje me strategjitë e arsimit të sotëm. Ato rregulla tashmë quhen të ezauruara, të zbatueshme nga trupat pedagogjike. Mendoj se vetëm kështu, me punën dhe vullnetin e mësuesit në bashkëpunim me nxënësit, duke respektuar njëkohësisht të gjitha rregullat e shkollës, si për mësuesit, ashtu dhe për nxënësit, krijohet atmosferë pune e kënaqësie për cilindo që hyn në shkollë, prej nga ku dhe mund të mësohet. Në mbyllje dua të kujtoj se :

**" Mësuesi mbetet udhërrëfyesi i dijes, pasqyra e shkollës dhe njëkohësisht, njeriu më i vlerësuar për shoqërinë. Vetëm mësuesi mund ta ndryshojë shkollën, vetëm ai mund ta edukojë nxënësin dhe vetëm ai mund ta ndryshojë shoqërinë. "**

# Çfarë duhet të di mësuesi për shëndetin publik në shkolla?



## Marrë nga "Paketa për Programin e Promocionit Shëndetësor në Shkolla"

## Roli i aktorëve në trajtimin e problemeve shëndetësore

*Aktorët në trajtimin e problemeve shëndetësore janë:*
Mjeku i shkollës, infermieri i shkollës,
mjeku i familjes/infermieri, mësuesi, psikologu,
punonjësi social, të gjithë

### C. FËMIJË TË VEÇANTË

***Aktivitete të Edukimit***

**Mjeku dhe infermieri i shkollës;**

*• Të organizojë takime apo biseda me grupe nxënësish për të marrë njohuri të përgjithshme rreth fëmijëve me nevoja të veçanta ( që paraqiten në shkollë/ në zonën e tyre).*

*• Prindi, mjeku, infermieri, stafi pedagogjik depiston rastet e nxënësve me nevoja të veçanta.*

*• Mjeku , infermieri bashkëpunon në mënyrë individuale me nxënësit që kanë nevoja të veçanta që:*

*1. Nxënësi të përdorë aftësitë e veta komunikuese për të përmirësuar shëndetin vetjak.*

*2. Nxënësit e tjerë të kontribuojnë në shëndetin e bashkëmoshatarëve, të shkollës, të familjes së vet, komunitetit.*

**Mobilizim i Komunitetit**

*• Mjeku, infermieri dhe punonjësi social të organizojnë takime me komunitetin, në mënyrë që vetë komuniteti t'i vlerësojë fëmijët me nevoja të veçanta, veçanërisht në drejtim të respektimit të të drejtave të fëmijëve ( nxënësit me nevoja të veçanta).*

*• Mjeku, infermieri të bashkëpunojë me komunitetin, pushtetin lokal që çdo shkollë të ketë rrugë kalimi të veçantë për këta nxënës.*

*• Të bashkëpunojnë me median e shkruar dhe lokale.*

**1. Kuadri Rregullator, Vendime Politike Mbështetëse,**

**Mbështetje Ligjore**

**Ligji nr. 10107, datë 30.3.2009 "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë"**

**Ligji Nr. 10138, datë 11.5.2009 "Për Shëndetin Publik"**

**Ligji Nr. 7952, dt. 21.06.1995 "Per Sistemin Arsimor Parauniversitar - Klasa të veçanta"**

**Rregullorja e Urbanistikës, miratuar me VKM Nr. 401, dt. 25.06.2004**
**Rregullore për MPCSHSB lidhur me standardet për funksionimin e Qendrave Rezidenciale, për fëmijët me aftësi të kufizuara.**



### Aktivitete Mjekësore

*Mjeku, infermieri kryejnë trajnime me stafin pedagogjik dhe me nxënësit, për mënyrën e trajtimit dhe të dhënies së ndihmës së pare, në rast nevoje.*
*Psikologu bën këshillime, konsulta të veçanta me fëmijët me nevoja të veçanta.*

## USHQYERJA E SHENDETSHME

***Aktivitete të Edukimit***

**Mjeku dhe infermieri i shkollës;**

- *Përgatit temën lidhur me Ushqyerjen e Shëndetshme në bazë të kalendarit të promocionit dhe standardeve të edukimit shëndetësore në shkolla (Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Instituti i Kurrikulave dhe Trajnimit).*
- *Organizon dhe merr pjesë në takimet informuese me nxënësit si edhe me mësuesit lidhur me edukimin, promocionin shëndetësor për një ushqyerje të shëndetshme, sipas grupmoshës dhe zonës.*
- *Identifikon rastet e kequshqyerjes dhe informon prindërit, nxënësit dhe i trajton së bashku me psikologun /punonjësin social/ prindërit.*
- *Komunikon me autoritetet përkatëse (drejtorinë e shkollës dhe drejtorinë  e Shëndetit Publik) lidhur me ndryshimet e nevojshme në rregullatore.*
- *Bashkëpunon me Departamentin e Promocionit lidhur me promocionin dhe parandalimin  e kequshqyerjes.*
- *Organizon takime individuale,  për rastet e identifikuara nga vete nxënësit, apo nga personeli si edhe organizon takime në grup për dhënie informacioni që përputhet edhe me njohjen e kushteve që u përmëndën më lart. Organizon edhe takime me prindërit.*
- *Kontrollon ushqimin në rastet kur pergatitet në kuzhinë.*
- *Siguron zbatimin e politikave shëndetësore  në shkollë për  një ushqyerje të shëndetshme në shkollë.*

### Mobilizim i Komunitetit

*Mjeku dhe infermieri i shkollës;*

- *Promovon ushqimet më me vlerë në përputhje me kushtet specifike të zonës.*
- *Organizon biseda në komunitet, apo në kolektiv.*
- *Shpërndan fletë palosje, broshura , postera për një ushqyerje më të shëndetshme.*

**Kuadri Rregullator, Vendime Politike, Mbështetje Ligjore. Strategjia e Promocionit.**
**Ligji Nr. 10107, dt. 30.03.2009,  "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë"**

**Ligji Nr. 10 138, datë 11.5.2009 "Për Shëndetin Publik".**
**Ligji Nr. 9942, dt. 26/06/2008 "Për parandalimin e ç'rregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut".**

**Udhëzuesi Dietetik.**

*Aktivitete Mjekësore (përfshirë depistime dhe ndërhyrje të tjera)*
*Mjeku i Shkollës bashkëpunon me Inspektoriatin Sanitar, për sigurinë e produkteve ushqimore që tregtohen në shkolla.*



## PARANDALIMI I SEMUNDJEVE NGJITESE

### *Aktivitete të Edukimit*
### Mjeku/infermieria e shkollës;

• *Përgatit temat mbi SST në bazë të kalendarit të promocionit dhe standardeve të edukimit shëndetësor në shkolla (Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Instituti i Kurrikulave dhe Trajnimit).*
• *Edukon/jep njohuri mbi higjienën personale, si mënyra e praktikës së larjes së duarve, mos shkëmbimi i veshjeve intime.*
• *Edukon/ jep njohuri për një jetë të shëndetshme, ushqyerja, jetesa në mjedise të pastra, të ajrosura mirë, rëndësia e aktivitetit fizik.*
• *Edukon/ jep njohuri lidhur me sëmundjet infektive, rrugët e marrjes dhe mënyra parandalimit të tyre, si;*
*- qëndrimi ndaj të sëmurëve infektivë për të mbrojtur veten.*
*- qëndrimi ndaj të tjerëve, për t'i mbrojtur nga sëmundjet infektive të vetë personit.*
• *Trajnim i mësuesve të shkollës ( nëpërmjet bisedave, materialeve informuese) lidhur me sëmundjet infektive dhe parandalimin e tyre.*
• *Informon prindërit në rast nevojash.*
• *Shpërndan materiale informuese.*
• *Promovon vaksinimin për epindemitë sezonale.*
• *Edukon/ jep njohuri mbi mjedisin, ambientin e pastër.*

### Mjeku/ infermieri i familjes;

• *Në bashkëpunim me personelin shëndetësor të shkollës, ndjekin zbatimin e kalendarit të vaksinimit si dhe promovojnë vaksinimin për epidemitë sezonale.*
• *Bëjnë biseda në klinikë si dhe shpërndajnë materiale informuese, kryejnë vizita në shtepi.*

### *Mobilizimi i Komunitetit*
### Mjeku i shkollave;

• *Bashkëpunon me Pushtetin Lokal për mirëmbajtjen e ambienteve të jashtme të shkollave dhe qytetit /fshatit (eliminimi I mbeturinave, qytet të gjelbëruara, sigurimi I rrjetit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza).*
• *Sensibilizon komunitetin për mbajtjen e higjienës dhe ndjekjen e këshillave.*
• *Përfshin e median elektronike dhe të shkruar në fushat e promocionit.*

**Kuadri Rregullator, Vendime Politike Mbështetëse, Mbështetje Ligjore**

*Mjeku i shkollave informon DSHP e rrethit për gjendjen, veçanërisht për mbylljen e shkollave në rast evidentimi epidemie, karantina në spitale, dezinfektimi në rast nevoje të ambienteve të shkollës.*

**Ligji Nr. 10107, dt. 30.03.09 "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë"**
**Ligji Nr. 10138, datë 11.5.2009 "Për Shëndetin Publik" Strategjia e Promocionit**

***Aktivitete Mjekësore***
**Mjeku, infermieri i shkollës, duhet të ndjekë:**

- *Depistimin periodik në fillim të vitit, për klasat e para dhe çdo tre muaj për të gjithë nxënësit e shkollave.*
- *Jep ndihmën e pare në rast nevoje.*
- *Evidenton nxënësit me patologji dhe i referon tek specialisti.*
- *Rehatimi i sëmundshmërisë parazit/skabie.*
- *Në rast dyshimi ose shpërthimi epidemie, pandemik, ndërhyn sipas rastit.*



## *"Mësuesi Model 2010-2011" do të jetë ai/ajo që punon përditë, me profesionalizëm, karakter e përkushtim.*

Propozimet për çmimet mund të vijnë nga nxënës, student, prindër, grupe e komunitete. Emri i propozuesit duhet të jetë i qartë dhe të ketë adresë të saktë për mundësi kontaktimi të mëtejshëm. Propozimi duhet të bëhet për mësues që japin mësim aktualisht, në shkollat tona.

Dërgoni emrin e plotë të mësuesit, shkollën, vendin, dhe shpjegimin se pse ju mendoni që i propozuari duhet të jetë "Mësuesi Model 2010-2011". Të gjitha propozimet do të shqyrtohen me vëmendje, dhe për kandidaturat më të spikatura do të ketë shqyrtim direkt në shkollë e komunitet.

## *"Fotografia më e mirë 2010-2011" do të jetë ajo që pasqyron arsimin shqiptar në shekullin e ri.*

Pjesëmarrja në konkursin e fotografisë është e hapur për të gjithë shqiptaret kudo që jetojnë në Shqipëri dhe diasporë. Fotografitë mund t'i dërgoni në adresën e revistës, me postë, në CD ose të printuara. Duhet të shkruani kohën dhe vendin se ku është bërë fotografia. Gjithmonë duhet të na dërgoni informacion të saktë kontakti, për ta patur në rast se fotografia juaj përzgjidhet fituese.

*Thuaj Faleminderit, propozoje për çmimin e madh, mësuesin që ju frymëzon e drejton për një jetë më të mirë e me dinjitet.*

*Dërgoni në redaksi fotografi që tregojnë kapërcim sfidash, humanizëm dhe vizion për arsimin shqiptar në shekullin e 21*



*Edukatorja Donika Dervishi, në një orë mësimi me fëmijët parashkollorë në Prezë të Tiranës.*


*Si mund të kontaktoni me ne:*



**Nina Gjoci:**
ngjoci@mash.gov.al; cel. 068 4078913



**Andon Andoni:**
aandoni@mash.gov.al; cel. 068 2246227



**Vjollca Spaho:**
vspaho@mash.gov.al; cel. 069 5376532


## Numri i ardhshëm:

*Probleme të mësimdhënies së letërsisë dhe të gjuhës shqipe përmes testit të klasës së nëntë dhe testeve të Maturës Shtetërore.*

*Edukimi në Fizikë: Fizika edukative i referohet metodave të tanishme pedagogjike që përdoren për të mësuar fizikën, si dhe asaj pjese të kërkimeve pedagogjike që kërkojnë të përmirësojnë këto metoda.*

*Vazhdim: "Çfarë duhet të di mësuesi për shëndetin publik në shkolla?"*


**Adresa e redaksisë: Rruga e Durrësit (pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës), nr. 23 - Tiranë**
**tel. 04 2227206 - revistamesuesi@mash.gov.al**
**U shtyp në shtypshkronjën "ALBDESIGN" - Autostrada Tiranë-Durrës km. 5 - www.alb-design.net**